Numri i fermerëve bletar përfitues të Pagesave Direkte është 2764 me gjithsej 164739 koshere të bletëve. Krahasuar me vitin 2017 numri i fermerëve përfitues është rritur për 297 fermerë ndërsa numri i koshereve të subvencionuara është rritur për 11702 koshere.


Te kjo masë e subvencionimit kemi pasur një tentim të madh të mashtrimit nga ana e fermerëve, janë refuzuar gjithsej 243 fermerë, ndërsa numri i kosherëve të refuzuara është 35068 koshere. Nëse e shprehim në vlerë monetare numrin e koshereve të refuzuara ky dëm që do i behej buxhetit është 526,020.00 €.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për Pagesa Direkte-Bletë sipas komunave :

Tabela 45 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kosheret e subvencionuara – Bletë 2018

Nr	Komuna	Nr. Aplikuesve	Nr.koshereve të aplikuara	Nr.fermerëve të refuzuar	Nr.koshereve të refuzuara	Nr. Përfituesve	Nr.Koshereve të subvencionuara	Shuma
1	Deçan	82	5,469	6	894	76	4,575	68,625.00
2	Gjakovë	155	11,099	15	2,409	140	8,690	130,350.00
3	Glllogoc	90	5,692	7	1,217	83	4,475	67,125.00
4	Gjilan	102	6,013	2	456	100	5,557	83,355.00
5	Dragash	72	4,626	5	710	67	3,916	58,740.00
6	Istog	163	9,768	20	1,496	143	8,272	124,080.00
7	Kaçanik	50	2,470	3	240	47	2,230	33,450.00
8	Klinë	83	4,497	6	562	77	3,935	59,025.00
9	F.Kosovë	31	1,845	1	37	30	1,808	27,120.00
10	Kamenicë	103	6,764	8	1,406	95	5,358	80,370.00
11	Mitrovicë	109	9,013	18	3,205	91	5,808	87,120.00
12	Leposaviq	69	3,995	1	128	68	3,867	58,005.00
13	Lipjan	70	4,180	7	561	63	3,619	54,285.00
14	N.Bërd	37	2,180	2	251	35	1,929	28,935.00
15	Obiliq	49	3,169	6	691	43	2,478	37,170.00
16	Rahovec	80	5,901	6	1,579	74	4,322	64,830.00
17	Pejë	197	13,330	21	2,199	176	11,131	166,965.00
18	Podujevë	133	8,379	8	1,574	125	6,805	102,075.00
19	Prishtinë	215	14,495	9	1,425	206	13,070	196,050.00
20	Prizren	115	7,556	14	1,557	101	5,999	89,985.00
21	Skenderaj	198	15,616	19	5,019	179	10,597	158,955.00
22	Shtime	49	2,884	1	122	48	2,762	41,430.00
23	Shtërpce	45	2,715	1	97	44	2,618	39,270.00
24	Suharekë	142	10,048	12	1,313	130	8,735	131,025.00
25	Ferizaj	113	7,253	11	928	102	6,325	94,875.00
26	Viti	83	4,847	4	407	79	4,440	66,600.00
27	Vushtrri	137	11,820	10	2,517	127	9,303	139,545.00
28	Z.Potok	23	1,306	-	0	23	1,306	19,590.00
29	Zveçan	16	906	-	0	16	906	13,590.00
30	Malishevë	91	5,597	15	1,300	76	4,297	64,455.00
31	Junik	13	1,064	2	461	11	603	9,045.00
32	Mamushë	3	370	1	145	2	225	3,375.00
33	H.Elezit	24	1,335	-	76	24	1,259	18,885.00
34	Graçanicë	31	1,631	1	38	30	1,593	23,895.00
35	Ranillukë	18	900	1	48	17	852	12,780.00
36	Partesh	11	807	-	0	11	807	12,105.00
37	Klllokot	5	267	-	0	5	267	4,005.00
		3,007	199,807	243	35,068	2,764	164,739	2,471,085.00

Figura 15 Shuma e pagesave për Pagesa Direkte-Bletë për vitet 2016, 2017 dhe 2018




Pagesat Direkte- Thëllëza

Sa i përket Pagesave Direkte për Thëllëza ka një numër të vogël të fermerëve që merren me këtë veprimtari dhe gjithashtu edhe numri i Thëllëzave të subvencionuara është i vogël. Kanë aplikuar gjithsej 13 fermerë me një fond prej 47,395 thëllëza. Pas kontrollës në terren kanë përfituar 13 fermerë në shumën totale prej 18,280.00 €. Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për Pagesa Direkte-Thelleza sipas komunave:

Tabela 46 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe kreret e subvencionuara –Thelleza 2018

Nr	Komuna	Nr. fermerëve aplikues	Nr.thëllëzave në aplikim	Nr.fermerëve të refuzuar	Nr.thëllëzave të refuzuara	Nr. Përfituesve	Nr.thëllëzave të subvencionuara	Shuma
1	Glogoc	1	25,000	-	8,000	1	17,000	8,500.00
2	Dragash	3	2,370	-	330	3	2,040	1,020.00
3	F.Kosovë	1	980	-	80	1	900	450.00
4	Mitrovicë	2	12,200	-	2,220	2	9,980	4,990.00
5	Pejë	1	500	-	0	1	500	250.00
6	Podujevë	1	250	-	0	1	250	125.00
7	Prizren	2	1,830	-	60	2	1,770	885.00
8	Skenderaj	1	1,000	-	30	1	970	485.00
9	Vushtri	1	3,265	-	115	1	3,150	1,575.00
		13	47,395	-	10,835	13	36,560	18,280.00

Figura 16 Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Thëllëza për vitet 2016, 2017 dhe 2018




Pagesat Direkte - Material fidanor

Pagesat Direkte per material fidanor kanë vazhduar edhe në vitin 2018. Numri i subjekteve juridike që kanë aplikuar në këtë sektor është 15 me gjithsej 542,110 fidane të prodhuara. Në kuadër të këtij sektori janë edhe fidanet e rrushit. Kanë përfituar 15 subjekte juridike në shumën totale prej 82,046.00 €.

Tabela 47 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i fidaneve të subvencionuar sipas komunave per vitin 2018

Nr	Komuna	Nr. Aplikuesve	Nr.Fidaneve të aplikuar	Nr.fermerëve të refuzuar	Nr.Fidaneve të refuzuara	Nr. Përfituesve	Nr.Fidaneve të subvencionuara	Shuma
1	Deçan	1	34,000	-	-	1	34,000	6,800.00
2	Gjakovë	2	78,250	-	-	2	78,250	15,650.00
3	Gjilan	1	18,200	-	6,580.00	1	11,620	2,324.00
4	Istog	1	31,000	-	-	1	31,000	6,200.00
5	Klinë	2	79,800	-	-	2	79,800	15,960.00
6	Kamenicë	4	73,800	-	-	4	73,800	14,760.00
7	Suharekë	1	23,000	-	-	1	23,000	4,600.00
8	Ferizaj	1	6,060	-	300.00	1	5,760	1,152.00
9	Malishevë	1	52,000	1	52,000.00	-	0	-
10	Rahovec	2	146,000	-	-	2	146,000	14,600.00
		16	542,110	1	58,880.00	15	483,230	82,046.00

Figura 17) Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Material fidanor për vitet 2016, 2017 dhe 2018



Pagesat Direkte - Pula vojse


Fermerët që merren me shpeztari janë subvencionuar edhe në vitin 2018. Subvencionimi është bërë për të gjithë fermerët që kanë pasur minimum 2000 pula vojse në prodhimtari aktive.

Kanë aplikuar 88 fermer me gjithsej 1,160,250 krerë të pulave vojse. Pas perfundimit të kontrollit në terren dhe procedurave tjera administrative, kanë përfituar 81 fermer-subjekte juridike në shumën totale prej 484,343.10 €. Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për Pagesa Direkte-Pula vojse sipas komunave:

Tabela 48 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i pulave të subvencionuara sipas komunave per vitin 2018

Nr	Komuna	Nr. Aplikuesve	Nr.pulave të aplikuar	Nr.fermerëve te refuzuar	Nr.pulave të refuzuara	Nr. Përfituesve	Nr.pulave të subvencionuara	Shuma
1	Deçan	1	5,000	-	23	1	4,977	2,488.50
2	Gjakovë	10	309,620	-	1,879	10	307,741	131,531.70
3	Glogoc	1	15,000	-	530	1	14,470	5,788.00
4	Gjilan	1	15,000	-	3,000	1	12,000	5,800.00
5	Dragash	1	4,800	-	170	1	4,630	2,315.00
6	Istog	2	28,500	-	0	2	28,500	13,300.00
7	Kaçanik	-	0	-	0	-	0	-
8	Klinë	1	6,500	-	250	1	6,250	3,125.00
9	F.Kosovë	2	9,900	-	300	2	9,600	4,800.00
10	Kamenicë	-	0	-	0	-	0	-
11	Mitrovicë	1	78,000	-	78,000	1	0	20,040.00
12	Leposaviq	-	0	-	0	-	0	-
13	Lipjan	1	4,000	1	4,000	-	0	-
14	N.Bërd	1	2,050	1	2,050	-	0	-
15	Obiliq	-	0	-	0	-	0	-
16	Rahovec	7	61,400	-	2,444	7	58,956	27,980.40
17	Pejë	8	74,100	-	1,160	8	72,940	34,018.00
18	Podujevë	9	152,800	-	510	9	152,290	69,196.00
19	Prishtinë	11	85,380	-	12,595	11	72,785	37,201.50
20	Prizren	9	51,600	3	16,908	6	34,692	17,156.00
21	Skenderaj	1	5,000	1	5,000	-	0	-
22	Shtime	2	13,500	-	0	2	13,500	6,750.00
23	Shtërpce	-	0	-	0	-	0	-
24	Suharekë	4	83,000	1	7,300	3	75,700	32,480.00
25	Ferizaj	6	77,100	-	90	6	77,010	34,605.00
26	Viti	4	16,500	-	0	4	16,500	8,250.00
27	Vushtrri	3	53,000	-	240	3	52,760	23,380.00
28	Z.Potok	1	6,000	-	100	1	5,900	2,950.00
29	Zveçan	-	0	-	0	-	0	-
30	Malishevë	1	2,500	-	30	1	2,470	1,188.00
31	Junik	-	0	-	0	-	0	-
32	Mamushë	-	0	-	0	-	0	-
33	H.Elezit	-	0	-	0	-	0	-
34	Graçanicë	-	0	-	0	-	0	-
35	Ranillukë	-	0	-	0	-	0	-
36	Partesh	-	0	-	0	-	0	-
37	Kllokot	-	0	-	0	-	0	-
		88	1,160,250	7	136,579	81	1,023,671	484,343.10

Figura 18 Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Pula vojse për vitet 2015, 2016 dhe 2017




Pagesat Direkte-Dosa

Pagesat Direkte për Dosa në prodhimtari aktive kanë vazhduar edhe në vitin 2018. Numri i fermerëve që merren me këtë prodhimtari ka shënuar një rritje të vogël prej vitit në vit. Janë gjithsej 210 aplikues prej të cilëve 202 fermerë kanë përfituar subvencione në vlerë totale prej 27,320.00 €, pra janë refuzuar 8 fermerë të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e parapara. Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për Pagesa Direkte-Dosa sipas komunave:

Tabela 49 Numri i aplikuesve, përfituesve, të refuzuarve dhe numri i dosave të subvencionuara sipas komunave per 2018

Nr	Komuna	Nr. Aplikuesve	Nr.dosave të aplikuar	Nr.fermerëve të refuzuar	Nr.dosave të refuzuar	Nr. Përfituesve	Nr.dosave të subvencionuar	Shuma
1	Gjakovë	11	55	-	0	11	55	1,100.00
2	Gjilan	12	83	-	19	12	64	1,280.00
3	Istog	2	13	-	0	2	13	260.00
4	Klinë	30	120	3	13	27	107	2,140.00
5	Leposaviq	11	164	1	9	10	155	3,100.00
6	N.Bërd	32	120	1	5	31	115	2,300.00
7	Obiliq	2	8	-	0	2	8	160.00
8	Pejë	4	36	1	5	3	31	620.00
9	Prizren	1	8	-	0	1	8	160.00
10	Skenderaj	1	13	-	0	1	13	260.00
11	Shtërpce	1	31	-	0	1	31	620.00
12	Viti	3	248	-	0	3	248	4,960.00
13	Vushtrri	6	72	1	15	5	57	1,140.00
14	Z.Potok	1	6	-	0	1	6	120.00
15	Zveçan	8	66	-	0	8	66	1,320.00
16	Graçanicë	13	105	1	10	12	95	1,900.00
17	Ranillukë	11	29	-	2	11	27	540.00
18	Partesh	39	113	-	3	39	110	2,200.00
19	Klllokot	22	167	-	10	22	157	3,140.00
		210	1,457	8	91	202	1,366	27,320.00

Figura 19 Krahasimi i shumës së pagesave për Pagesa Direkte-Dosa për vitet 2016, 2017 dhe 2018



Pagesat Direkte-Qumësht sipas cilësisë

Subvencionimi i fermerëve për Pagesa Direkte-Qumësht sipas cilësisë ka vazhduar edhe në vitin 2018. Numri i fermerëve aplikues ka shënuar rritje të vogël në krahasim me vitin 2018. Shuma totale e paguar për Pagesa Direkte-Qumësht sipas cilësisë për vitin 2018 ka qenë 1,736,943.50€. Në tabelën në vijim janë të paraqitura të dhënat për Pagesa Direkte-Qumësht sipas cilësisë sipas komunave:

Tabela 50 Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Qumësht sipas cilësisë 2018

Nr	Komuna	Nr. i fermerëve përfitues TM1	Nr. i fermerëve përfitues TM2	Nr. i fermerëve përfitues TM3	Nr. i fermerëve përfitues TM4	Pagesa TM1	Pagesa TM2	Pagesa TM3	Pagesa TM4
1	Prishtina	13	14	13	11	8,076.04	9,139.08	6,393.68	4,612.88
2	Lipjani	36	34	30	29	27,950.76	32,694.60	20,763.42	15,433.22
3	Podujeva	41	37	26	27	12,767.24	11,667.76	11,029.52	8,111.74
4	Obiliqi	11	11	12	11	4,388.16	2,575.42	2,735.40	2,282.12
5	Drenasi	30	30	27	23	8,950.00	10,515.78	7,293.90	7,033.88
6	F.Kosova	17	17	18	15	11,761.72	13,191.22	7,138.80	5,059.20
7	Graçanice	3	3	3	4	8,057.82	5,902.50	1,959.12	4,013.98
8	Dragashi	47	41	42	43	19,444.42	22,223.16	14,942.92	13,251.24
9	Rahoveci	81	77	57	55	48,762.52	42,690.63	25,638.90	23,825.14
10	Prizreni	11	10	12	15	8,686.15	6,184.27	7,384.91	6,838.02
11	Suhareka	29	31	28	23	7,329.17	8,906.67	7,808.54	4,406.22
12	Malisheva	57	43	40	34	23,797.42	22,196.20	18,085.54	10,434.60
13	Gjilani	21	20	23	20	11,173.16	11,174.14	13,000.10	7,899.80
14	Kamenice	4	5	5	2	1,453.92	1,532.06	1,005.60	690.08
15	NovoBerd	6	6	6	6	1,824.30	3,350.69	3,978.96	3,246.98
16	Vitia	13	14	18	13	6,275.92	9,732.92	9,785.62	4,941.18
17	Ferizaj	19	16	14	14	12,600.58	12,271.08	11,217.22	9,036.04
18	Shtimja	8	7	7	7	3,941.70	3,110.78	3,361.56	2,343.02
19	Mitrovica	2	1	1	1	2,029.98	1,380.30	620.80	223.50
20	Skenderaj	23	23	24	27	10,434.42	10,157.73	9,556.59	15,021.26
21	Vushtrri	52	51	54	58	21,944.38	19,781.1	19,882.48	19,638.30
22	Deçani	21	24	30	28	20,307.32	21,542.34	21,205.54	24,180.64
23	Gjakova	80	87	73	74	51,244.65	56,958.44	41,878.64	43,601.36
24	Peja	83	76	78	75	72,472.06	78,755.90	70,889.28	55,204.20
25	Istogu	61	63	68	70	42,345.98	49,442.14	45,919.86	36,330.02
26	Klina	36	34	38	37	28,427.10	28,343.00	27,216.38	24,852.34
27	Mamushe	1	2	2	1	891.84	358.34	567.00	55.29
	TOTALI	806	777	749	723	477,338.73	495,778.24	411,260.28	352,566.25

Pagesat Direkte për therrjet e raportuara të gjedhit

Pagesat Direkte për therrjet e raportuara të gjedhit nuk kanë zgjuar ndonjë interesim të madh në vitin 2018. Kanë aplikuar vetëm 7 therrtore. Numri i kafshëve të therrura të raportuara ka qenë gjithsej 978 krerë dhe shuma totale e paguar ka qenë 48,900.00€ . Ka një rritje rreth 100% të aplikimit krahasuar me vitin 2017, mirëpo baza ishte shumë e ulët në vitin 2017, kishte vetem tri therrtore aplikuese.

Tabela 51 Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Therrjet e raportuara të gjedhit, 2018

Nr	Komuna	Nr. i fermerëve përfitues TM1	Nr. i fermerëve përfitues TM2	Nr. i fermerëve përfitues TM3	Nr. i fermerëve përfitues TM4	Pagesa TM1	Pagesa TM2	Pagesa TM3	Pagesa TM4
1	Suhareka	1	1	1	1	1,300.00	1,150.00	1,200.00	2,000.00
2	Mitrovice	1	1	1	1	3,150.00	2,400.00	800.00	4,050.00
3	Vushtrri	1	1	1		850.00	1,250.00	600.00	
4	Gjakove	2	2		2	5,500.00	8,700.00		4,050.00
5	Pejë	2	1			2,750.00	1,650.00		
6	Istog				1				2,900.00
7	Malisheve		1	1	1		1,050.00	2,200.00	1,350.00
	TOTALI	7	7	4	6	13,550.00	16,200.00	4,800.00	14,350.00

Pagesat Direkte - Verë e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht

Pagesat Direkte për verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht janë përkrahur edhe në vitin 2018. Numri i kompanive aplikuese ishte gjithsej 16 kompani me një sasi prej 5,342,171 litra verë. Janë subvencionuar 14 kompani ndërsa dy prej tyre janë refuzuar. Shuma totale e paguar për sasinë e verës së prodhuar ishte 190,774.32€.

Tabela 52 Numri i përfituesve dhe pagesa sipas komunave, Verë e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, 2018

Nr	Komuna	Nr. Aplikuesve	Sasia e aplikuar / liter	Nr.fermerëve të refuzuar	Sasia e refuzuar/litër	Nr. Përfituesve	Sasia subvencionuar / liter	Shuma
1	Rahovec	13	4,772,821.00	-	5,543.00	13	4,767,278.00	190,691.12
2	Prizren	1	3,700.00	1	3,700.00	-	-	-
3	Suharekë	2	565,650.00	1	563,570.00	1	2,080.00	83.20
	TOTALI	16	5,342,171.00	2	572,813.00	14	4,769,358.00	190,774.32

Pagesat Direkte - Akuakulturë

Pagesat Direkte për Akuakulturë kanë vazhduar edhe në vitin 2018. Në gjashtëmuajorin e parë 2018 janë përkrahur gjithsej 1 kompani në shumën totale 32,639.09€, ndërsa në gjashtëmuajorin e dytë 2018 janë përkrahur 4 kompani në shumën totale 53,429.20€. Në total për vitin 2018 shuma e subvencionimit për këtë sektor ka qenë 86,068.29€

Përmbledhje e Pagesave Direkte

Mbështetja e fermerëve përmes Pagesave Direkte po ndikon në rritjen e prodhimtarisë bujqësore si të fermerët që merren me kultivimin e drithërave e poashtu edhe të fermerët që mirren me blegtori dhe hortikulturë. Bazuar edhe në të dhënat e lartëcekura vërehet se në shumicën e sektorëve ka rritje të numrit të fermerëve përfitues.

Numri i fermerëve përfitues për vitin 2018 është gjithsej 48,320 ose 3702 fermerë më shumë se sa në vitin 2017, ndërsa sa i përket shumës totale të pagesës në vitin 2018 është 29,648,238.57€.

Numri i përgjithshëm i fermerëve të refuzuar ende është i lartë, janë refuzuar gjithsej 1734 fermer ose 3.46% e fermerëve aplikues. Numër pothuajse i njëjtë i fermerëve të refuzuar krahasuar me vitin 2017.

Implementimi i Programit për Pagesa Direkte në mënyrën më të mirë ende mbetet sfidë për shkak të numrit të vogël të stafit, nuk ka staf me kontrata të përhershme dhe stabile. Ndërrimi i shpeshtë i stafit me kontrata për shërbime të veçanta po sjell edhe probleme në implementim si dhe cilësia e kontrollit të aplikacioneve nuk është në nivelin e duhur.


Gjatë implementimit të Programit për Pagesa Direkte po ka vështirësi tek identifikimi i parcelave të aplikuesve për shkak se ka mospërputhje në mes të kadastrit-fletave poseduese dhe sipërfaqeve të digjitalizuara përmes sistemit LPIS.

Miratimi me vonesë i Programit për Pagesa Direkte gjithashtu po sjell vështirësi sepse po mbetet një numër i madh i fermerëve pa u kontrolluar në terren. Ne kemi respektuar me përpikëri përqindjet e kontrollit në terren sipas Udhezimit Administrativ nr.03/2018 për Pagesa Direkte në bujqësi, mirëpo tendencat për mashtrime ende janë të mëdha dhe përqindjet e kontrollit në terren nuk po sjellin një pasqyrim të vërtetë të gjendjes reale në terren. Vetëm te sektori i bletarisë, kemi shpëtuar mbi 500.000.00 € për të cilat fermerët kanë deklaruar rrejtshëm dhe kanë tentuar mashtrime. Pra sa më shumë që kontrollohet në terren aq më pak do të paguajmë. Totali i aplikuesve, përfituesve dhe shumës së pageses për të gjithë programin e Pagesave Direkte për vitin 2018 është sipas tabelës në vijim:

Tabela 53 Totali i aplikuesve, përfituesve të refuzuarve dhe shuma e pagesës sipas

Nr	Emertimi-Sektoret e perkrahur	Nr.aplikuesve	Nr.përfituesve	Nr.refuzuarve	Sip/krere/liter/kg e subvencionuar	Shuma
1	Pagesa Direkte-Grure	10683	10311	372	43,672.86	6,550,929.00
2	Pagesa Direkte-Fare Gruri	11	11	0	458.44	114,204.00
3	Pagesa Direkte-Miser	8432	8165	267	21,518.56	3,227,784.00
4	Pagesa Direkte-Elb	316	306	10	517.92	77,688.00
5	Pagesa Direkte-Theker	83	72	11	195.62	29,343.00
6	Pagesa Direkte-Luledielli	5	4	1	4.99	748.50
7	Pagesa Direkte-Perime	6664	6435	229	8,976.63	2,693,020.89
8	Pagesa Direkte-Pemishte ekzistuese	5278	5097	181	4,763.84	1,905,547.97
9	Pagesa Direkte-Vreshta ekzistuese	3012	2949	63	2,580.25	2,580,250.00
10	Pagesa Direkte-Bujqesi organike	37	24	13	443.22	277,578.00
11	Pagesa Direkte-Lope qumeshtore dhe buallica	7595	7395	200	67,811	4,746,770.00
12	Pagesa Direkte-Dele	1171	1130	41	138,012	2,070,180.00
13	Pagesa Direkte-Dhi	265	248	17	15,229	228,435.00
14	Pagesa Direkte-Dosa	210	202	8	1,366	27,320.00
15	Pagesa Direkte-Pula	88	81	7	1,023,671	484,343.10
16	Pagesa Direkte-Blete	3007	2764	243	164,739	2,471,085.00
17	Pagesa Direkte-Thellenza	13	13	0	36,560	18,280.00
18	Pagesa Direkte-Material fidanor	16	15	1	483,230	82,046.00
19	Pagesa Direkte-Qumesht sipas cilesise TM1	825	806	19	8,845,952.84	477,338.73
	Pagesa Direkte-Qumesht sipas cilesise TM2	791	777	14	9,988,063.45	495,778.24
	Pagesa Direkte-Qumesht sipas cilesise TM3	763	749	14	8,196,887.21	411,260.28
	Pagesa Direkte-Qumesht sipas cilesise TM4	737	723	14	7,491,510.80	352,566.25
20	Pagesa Direkte-Therrjet e raportuara te gjedhit TM1	7	7	0	271	13,550.00
	Pagesa Direkte-Therrjet e raportuara te gjedhit TM2	8	7	1	324	16,200.00
	Pagesa Direkte-Therrjet e raportuara te gjedhit TM3	6	4	2	96	4,800.00
	Pagesa Direkte-Therrjet e raportuara te gjedhit TM4	7	6	1	287	14,350.00
21	Pagesa Direkte-Vere/Liter	16	14	2	4,769,358	190,774.32
22	Pagesa Direkte-Akuakulture	8	5	3	430,341.45	86,068.29
	TOTALI	50054	48320	1734	41,736,690.05	29,648,238.57

Figura 20 Shumat totale e pagesave për Pagesat Direkte për vitet 2016, 2017 dhe 2018



Drejtoria e Kontrollit

Drejtoria e Kontrollit edhe gjatë vitit 2018 ka zhvilluar një gamë të gjërë aktiviteteve në realizimin e kontrollit në teren të aplikantëve për Programin e Masave Mbështetëse në Bujqësi të aplikuar nga MBPZHR dhe kritereve të përcaktuara nga Autoriteti Menaxhues. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara janë bazuar në përgatitjen, aplikimin dhe realizimin sa më të mirë të mundshëm të metodave të kontrollit dhe verifikimit të aplikantëve dhe nxjerren e sakt të të gjeturave sipas kërkesave të Programit, kritereve dhe sektorëve të AZHB-së, bazuar Kërkesat Ligjore dhe mundësitë , Humane dhe Logjistike që posedon kjo Drejtori. Përveç punëve të zakonshme të cilat i ka të përshkruara me ligj, Drejtoria e Kontrollit kryen edhe aktivitete në ndihmë të drejtorive tjera për shkak të mungesës së personelit. Në shtatë Zyrat Regionale, kryen aktivitetin e Pranimit të Dokumentacionit të Aplikantëve për grante për Drejtorinë e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural, si dhe Kërkesat për Pagesë për Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, me ç'rast dalin jashtë sistemit të kontrollit të Projekteve të Zhvillimit Rural minimum shtatë inspektorë. Drejtoria e Kontrollit në teren është një institucion i cili përballon gjithë volumin e kërkesave për kontroll duke filluar me Pagesa Direkte, kontrolli Para Miratimit (Drejtoria e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural), Kontrolli pas Miratimit dhe Para Pagesës (Drejtoria e Autorizimit), Rikontrollin (Me kërkesë të Drejtorive të Lartëcekura dhe Komisioneve të Ankesave, Superkontrollin dhe Ex-Post Kontrollin).

Vështrim i Përgjithshëm i Aktiviteteve të Zhvilluara - Drejtoria e Kontrollit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë operon me një staf prej 37 të punësuarish të Rregullt prej të cilëve 3 janë të sistemuar në Zyrën Qendrore të Drejtorisë, të cilët merren me menaxhimin e kërkesave për kontroll dhe menaxhimin e punëve në përgjithësi, kurse 34 operojnë si Inspektor tereni në shtatë Zyrat Regjionale, duke kryer kontrollin fizik në vendngjarje. Poashtu Drejtoria e Kontrollit duke filluar nga muaj Shkurt -2018, është mbështetur me një staf prej 28 të punësuarisht në Marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenjes Sociale, prej të cilëve 4 janë angazhuar në Drejtori - Qendër, pjesa tjetër në kontrollin në teren duke u kombinuar me stafin e vjetër të kontrollit për kryerjen e kontrollit në vendngjarje. Pra, Resurset Njerëzore në Drejtorinë e Kontrollit në vitin 2018 kanë qenë 64. Në pjesën e dytë të vitit, (gjashtë mujorin e dytë) janë angazhuar 5 inspektorë të pjesës Veriore dhe numri total ka arritur në gjithsejtë 69 të angazhuar e që ka qenë ndihmë e madhe duke pasur parasysh volumin e madh të punëve që përballohen nga kjo Drejtori. Megjithatë duhet cekur se ndërrimi i shpeshtë i stafit ndihmës është pengesë shumë e madhe në realizimin me kohë dhe cilësi të kontrollit për arsye se çdo staf i ri që vie (e që përsëritet çdo vit), duke ditur se nuk njih procedurat e kontrollit i duhet kohë deri sa të kuptojë procedurat dhe të njohë punën.

Pas analizës vjetore të punës dhe nxjerrjes së konkluzioneve lidhur me proceset e realizimit të punëve në vitin paraprak, janë ndërmarrë masat e duhura për eliminimin e dobësive dhe përmirësimin e fushave ku janë shfaqur këto dobësi, si në dokumentacion, në qasjen ndaj Programeve dhe Projekteve, kontrollin fizik në teren etj.

Pas vlerësimit të permorfancës së të punësuarve për vitin paraprak të punës-2017 , në drejtori ka filluar hartimi i Planeve Individuale Vjetore të Punës dhe **Planeve Sektoriale të Punës për Kontrollin e Projekteve të Zhvillimit Rural dhe Pagesave Direkte dhe Planit të Përgjithshëm të Punës së Drejtorisë së Kontrollit**, të cilat përveç analizës së kontrollit nga viti paraprak, përfshirjes së resurseve në dispozicion ka paraparë edhe kornizën kohore të përfundimit të kontrollit për Programin e Ri të Mbështetjes në Bujqësi për vitin kalendarik – 2018.

Pas përfundimit të këtyre shqyrtimeve dhe analizave administrative janë bërë përgaditjet teorike dhe agjendat për trajnimet teorike dhe praktike në teren. Trajnimet janë konceptuar

kryesisht për masat e reja të shpallura më program dhe rifreskimin e njohurive dhe përforsimin e tyre në fushat ku në vitet paraprake kemi qëndruar më dobët. Trajnimi kryesorë është mbajtur në sallën e hotelit Amazona. Trajnimet e zhvilluara për stafin kanë qenë të lidhura me aktivitetet e kontrollit në terren që kryen Drejtoria e Kontrollit, Si e përsëritur nga vitet e kaluar (e cila ka dhënë rezultatet e veta), ka qenë futja në përdorim e sistemit të digjitalizimit të Parcelave në kontrollin e parë-PZHR (para Miratimit), ku kanë planifikuar të kryejnë investimet e tyre fermerët në terren.

Për kontrollin e pagesave direkte , është prezantuar programi i pagesave direkte, Masat e reja, metodat e kontrollit etj. poashtu në trajnimin kryesorë, janë prezantuar edhe doracakët e kontrollit ku janë detajizuar pikat e ndryshme të kontrollit, me ç'rast janë njoftuar të gjithë inspektorët për programin e masave mbështetëse për vitin 2018. Poshtu janë riformuluar raportet e kontrollit për të gjitha masat e projekteve të zhvillimit rural, lidhur me çështjen e kontrollit në terren sipas standardeve IPA-II, kriteret e kontrollit, përpunim i dokumentacionit për akreditim, vizita në terren dhe monitorim i kryerjes së kontrollit në vend ngjarje, Qarkullimi i dokumentacionit-Pranim - Dorzimi i lëndëve, kontrolli në vendngjarje për projektet e zhvillimit rural si dhe përvetësimi i kriterëve dhe specifikave të Programeve. Paraprakisht është mbajtur sesioni Informues për Inspektorë dhe janë hartuar dokumentet përkatëse.

Punët Logjistike - Duke ditur se stafi logjistik i AZHB-së është i limituar në këtë sektor të AZHB-së janë përcjellur vetëm shkresat, Raportet e automjeteve dhe kërkesat për servisim, kurse punët teknike dhe praktike janë kryer nga inspektorët e divizionit të kontrollit. Këtë vit ka qenë një rifreskim me disa automjete të reja të cilat kanë ndikuar pozitivisht në kryerjen e aktiviteteve të inspektimit dhe uljen e shpenzimeve të kontrollit.

Superkontrolli - Superkontrolli si proces i cili ka për qëllim monitorimin, verifikimin dhe mbikqyrjen e punës së inspektorëve këtë vit ka qenë më i organizuar më ekspeditiv dhe më i plotë sidomos kur është fjala tek Pagesat Direkte se vitet tjera të gjertanishme. Superkontrolli

është përqëndruar kryesisht në sektorin e bletarisë ku me kërkesë të drejtorisë së pagesave direkte është bërë kontrollë sipas Listave të kërkuara nga ta. Poashtu sipas kërkesës së drejtorit të drejtorisë së kontrollit , Superkontrollit i janë nënshtruar edhe mostra (lëndë), të aplikantëve për sipërfaqe – Grurë, Misër, Krerë.

Rikontroli – Viteve paraprake ka qenë praktikë që në kuadër të drejtorisë së kontrollit të funksiononte një komision i ankesave (Komision praparak, meqë ka shumë ankesa të padefinuara dhe që komisionet qendrore nuk mundë të zgjedhin shpejt disa nga rastet zgjidheshin shpejt për rikontrollë ose refuzim, varësisht nga situata, pastaj palët nëse janë ndarë të pakënaqura i janë drejtuar edhe komisionit qendror të ankesave për pagesa direkte). Këtë vit kjo praktikë është anuluar, (gjë që edhe na ka lehtësuar shumë punën e stafit), kështu që rikontroli i realizuar vetëm pas vendimeve që ka marrë komisioni qendror i ankesave për pagesa direkte, me ç’rast janë rishikuar dhe riverifikuar lëndët e kthyera nga ta , këtë vit anëtarët e komisionit qendrorë të ankesave për pagesa direkte, e kanë praktikuar edhe vet daljen në teren me ç’rast janë mbështetur nga ekipet tona të kontrollit në teren dhe kanë konstatuar gjendjen reale të fermerit.

Tabela 54 Numri i Superkontrolleve dhe Rikontrolleve të kryera gjatë vitit 2018

Nr.	Lloji i Superkontrollit	Numri i lëndëve të kryera
1.	Superkontroll për Pagesa Direkte	104
2.	Rikontroli - Vendime të Komisionit të Ankesave / PD	7
	Totali	111

Ex-Post Kontrolli – Sipas Ligjit në fuqi, Udhëzimit Administrativ dhe Vendimit të Zyrtarit Kryesorë të Institucionit, janë kryer Ex-Post Kontrolle për Përfituesit e Projekteve të Zhvillimit Rural të Vitit/Programit - 2015, gjithesej 227 kontrolle (aq lëndë sa na ka siguruar Arkiva), nga kontrolli për fermerët përfitues janë verifikuar gjendja e aktivitetit të biznesit për projektet e realizuara, posedimit të paisjeve të përfituara etj, për këtë çështje është hartuar raport i posaçëm me të dhënat nga të gjeturat e konstatuara për secilin përfitues.

Punët për Sektorët Tjerë - Vlenë të ceket pjesëmarrja e stafit në komisione të ndryshme, (kërkesave, ankesave etj) si dhe Zyrtarët - Inspektorët të cilët tashmë pothuajse çdo vit caktohen në zyrat regjionale për pranimin e dokumentacionit të aplikimit për projektet e zhvillimit rural dhe kërkesave për pagesë dhe punëve tjera që kërkojnë drejtoritë tjera të AZHB-së.

Raportimi - Ka vazhduar dhe është kthyer në traditë raportimi ditor, qarkullimi i madh i lëndëve dhe kërkesat e mëdha për kontrollë bëjnë që të jemi jashtëzakonisht të angazhuar në përcjelljen e situatës në vazhdimësi. Çdo herë dhe në çdo kohë monitorimi është i vazhdueshëm, përcjellja e numrit të kontrolleve, ekipeve, automjeteve, shpesh duke ndërhyrë në proces si për kompletimin e ekipeve të kontrollit aty ku janë paraqitur nevojat për raste të caktuara. Kështu që gjatë fushatës së kontrollit në teren, për masat e subvencioneve dhe projekteve të zhvillimit rural, është bërë praktikë e zakonshme. Si çdo vit me fillimin e kontrollit raportimi bëhet në baza: Ditore, Javore, Mujore dhe Vjetore.

KONTROLI I LËNDËVE PËR PAGESA DIREKTE

Kontrolli i Masave të Pagesave Direkte-Subvencioneve, është një sfidë mjaft e madhe sepse tek ne në Kosovë, (në mungesë të Sistemit AIAX), kontrolli është enorm, krahasuar me vendet tjera të Regjionit dhe më gjërë sepse të gjitha Agjencitë e të njëjtës fushë kontrollin e subvencioneve e bëjnë ose me nënkontraktues ose me % simbolike të kontrollit (Mostër), porë në këtë prizëmë në kontrollin e subvencioneve e kemi tepër të ngarkuar.

Duke pasur parasysh çështjen e lartëcekur sa i përket kontrollit në teren të Masave Subvencionuese mundë të themi se për vitin 2018 kontrolli ka qenë i realizuar sipas normave të parapara ligjore, Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, UA/03/2018, Programit për Pagesa Direkte-2018 dhe Rregullores së Drejtorisë së Kontrollit për Kontrollin e Pagesave Direkte.

Normat e kërkuara për kontrollë në teren, sipas UA//03/2018-Për Pagesa Direkte në Bujqësi dhe nga Drejtoria e Pagesave Direkte - Selektimi nga Sistemi elektronik për kontrollë kanë qenë në suaza të kriterëve të parapara, megjithëse pak të larta e poashtu jostandarde sepse për një aplikant p.sh. për kontrollin e drithrave është 40%, për pemishte 20, për perime 30 %, për Vreshta 40%, për kafshë 50 %, për Bletë 80 %, për fidane, Fëllënza, Dosa , Verëra, Bujqësi Organike të gjitha 100% etj, cilësia e Kontrollit Administrativ (DPD) ka pasur përmirësim dhe realizimi i kontrollit në teren ka avancuar drejtë një cilësie më të lartë krahasuar me vitet e kaluara.

Poashtu vlenë të ceket se këtë vit përveç parapërgatitjeve të zhvilluara, trajnimeve, doracakut, udhëzuesve, ka qenë shumë më efikase logjistika mbështetëse falë të cilës kontrolli është kryer në kohën e duhur dhe me shpenzime më të ulëta. Përvoja e arritur në menaxhimin e lëndëve, përcaktimit të ekipeve dhe zonave e fushave të kontrollit ka bërë që të mos mungojë efikasiteti i kryerjes së kontrollit me ç'rast është arritur që në kohë të paraparë të kryhet kontrolli të përcillën lëndët tek Drejtoria e Pagesave Direkte.

Në tri vitet e fundit, është bërë praktikë që aplikimi të jetë në një aplikacion për të gjitha Masat Subvencionuese, një herë të vizitohet fermeri dhe kontrollohet për të gjitha masat e aplikuar dhe kjo metodë kontrolli është shumë më e mirë, më e shpejtë si dhe ka zvoglim të shpenzimeve në teren , megjithëse duhet harmonizuar Normat e Kontrollit në përqindje të njëjtë për të gjitha masat.

Duhet theksuar se gjatë këtij viti Sektori i Kontrollit për Pagesa Direkte ka qenë më i kompletuar me staf dhe resurse tjera. Përveç, Shefit të Sektorit në asistencë të tij kanë qenë vazhdimisht dy zyrtare dhe sistemi elektronik i ngarkimit të lëndëve nga Drejtoria e Pagesave Direkte tek Sektori dhe Ekipi Kontrollues dhe anasjelltas. Poashtu ulja e normave të kontrollit gjatë këtij viti ka bërë që kontrolli të kryhet në kohë dhe me efikasitet.

Kontrolli i Kulturave Lavërtare

Kontrolli i Grurit - Ka filluar më: 04.05.2018 dhe ka përfunduar më: 10.10.2018. Kontrollit i janë nënshtruar 4,442 Aplikant-fermer që në përqindje i bie 41,60%. Prej totalit të Aplikantëve: 10,679.

Kemi filluar kontrollin në terren me, 20-21 ekipe të kontrollit. Inspektorati i terrenit ka fituar përvojë në leximin e hartave dhe në matje, kështu që nuk paraqet problem kontrolli i grurit dhe kulturave tjera lavërtare. Problem tek ky kontrollë paraqiten gabimet e digjitalizimit që i bëjnë fermerët, (zyrtarët gjatë digjitalizimit të parcelave në aplikim) dhe kjo është bërë dukuri, pastaj reagimi i fermerit i drejtohet ekipit të kontrollit me presion që t'a kalojë edhe pse është evidente e se gabimi është i tij.

Kontrolli i Elbit dhe Thekrës - kanë aplikuar gjithsejt: 399 fermer për Elb dhe Thekër dhe janë kontrolluar, 233 fermer ose 58,4 %, është viti i tretë që ka filluar subvencioni dhe kontrolli për këto dy kultura, kontrolli është i zakonshëm si për kulturat tjera lavërtare.

Kontrolli i Misrit - Për **Miser** kanë aplikuar gjithësejt: 8,421 fermer dhe janë kontrolluar 3,541 fermer, kontrolli është kryer për 42,05 % të tyre.

Luledielli: Kanë aplikuar gjithësej 5 fermer dhe të gjithë janë kontrolluar do të thotë kontrolli është kryer 100 %. Në përgjithësi nuk ka pasur probleme, është një kontroll rutinë që nuk shkakton shumë kokëçarje. Pas korrjes së grurit, mbeten parcelat me misër dhe luledielli dhe nuk është shumë i vështirë identifikimi i tyre. Problem i vetëm që paraqitet janë gabimet e digjitalizimit.

Kontrolli i Perimeve ne fushë të hapur dhe të mbyllur_- Perimet ne fushë të hapur, kanë aplikuar gjithësej 6,662 fermer dhe janë kontrolluar 2,964 fermer apo në përqindje 44,49%. Fermerët që aplikojnë për këto kultura ka raste që gjatë aplikimit bëjnë skicime - digjitalizime të ndryshme në krahasim me gjendjen në terren, do të thotë gjatë aplikimit deklarojnë tjetër

kulturë, në praktikë mbjellin kulturë tjetër nga e deklaruara. Pra, ndërrojnë vendet e kulturave perimore dhe gjatë kontrollit kanë ankesa për vlerësim të pasaktë. Perimkultura është fushë kontrolli ku tani për tani problemet janë më të theksuara për shkak të ndërrimit të vendëve të kulturave të mbjellura si dhe për shkak të sezonës së mbjelljes, disa janë kultura të hershme e disa të vonshme. Do të duhej që gjatë hartimit të programit për perimkulturën të precizoheshin koha e mbjelljes, kontrollit në teren dhe veçanërisht të kërkohej rendimenti tek kultura e kungujve.

Kontrolli i Kulturave Pemore- Pemishtet Drufrutore dhe Manore - Gjithësejt për kulturat Pemtare kane aplikuar: 5276, kontrollit i janë nënshtruar 1522 fermer ose 28,85 %. Tek pemishtet programi ka definuar më qartë kriteret e pranueshmerisë kështu që nuk ka probleme të veçanta gjatë kontrollit. Problem ndonjëherë paraqitën tek pemishtët manore si tharja e fidaneve me ç'rast aplikantët digjitalizojnë dhe paraqesin për subvencion edhe sipërfaqet të cilat nuk kanë rendiment. **Është një fushë ku nuk ka shumë problem.**

Kontrolli i materialit Fidanor- Materiali fidanor është kontingjent i vogël dhe përvoja e këtyre kater viteve është bartur te të gjitha ekipet. Kontrolli është kryer 100%, Kanë qenë gjithsejtë: 16 aplikantë dhe kontrolli është kryer tek 14 Aplikant sipas kërkesës së DPD .

Kontrolli i Vreshtave-Tek vreshtat, poashtu tashmë një fushë e njohur kontrolli, kontrollit i janë nënshtruar 932 fermer ose 31 % e kontogjentit aplikues. Problem te kontrolli i vreshtave paraqesin parcelat shumë të vogla si dhe parcelat shumë të mëdha të cilat aplikantët gjat aplikimit i ndajnë në rende që dmth, është mift e vëshitrë identifikimi i kufirit të njërit aplikant me tjetrin.

Kontrolli i Verërave - Është viti i dytë që aplikantët për liter vere që kontrollohen në vendngjarje, është kontigjent i vogël i aplikantëve dhe janë kontrolluar të gjithë. Kanë aplikuar 16 aplikantë dhe për kontrollë kanë qenë 14 aplikantë.

Kontrolli i Kafshëve dhe Bletëve - Kontrolli i kafshëve , vazhdon si proces, verifikimi sipas kërkesave të Programit Subvencionues duke u bazuar në Listat dhe Numrat e Pronave – Matrikujt, të përpiluara nga Databaza e Agjencionit të Veterinës dhe Ushqimit. Problemet të cilat paraqiten gjatë kontrollit dhe përcillen për vite të tera janë: Rënja e numrave të Matrikujve – Matrikujt e dobët, rifreskim i rrallë i databazës dhe futja e dy-tre pronave të vogla në një kod pronësor. Edhe ky lloji kontrolli tashmë është një rutinë për inspektoratin e Drejtorisë së Kontrollit.

- Për Lopë Qumështi kane aplikuar gjithsejtë : 7601, kontrollit i janë nënshtruar 3864 fermer ose 50.84 %.
- Për Dele Qumështi kane aplikuar gjithsejtë : 1163, kontrollit i janë nënshtruar 584 fermer ose 50.21 %.
- Për Dhi Qumështi kane aplikuar gjithsejtë : 264, kontrollit i janë nënshtruar 135 fermer ose 51.14 %.
- Për Dosa për riprodhim kanë aplikuar gjithsejtë : 209, kontrollit i janë nënshtruar 197 fermer ose 94,26 %.

Kontrollit i janë nënshtruar aplikant të kafshëve (Lopë qumështi, dele, dhi dhe dosa për riprodhim).

Kontrolli i Bletëve – Përveç kontrollit të grurit dhe perimeve, që janë sfidë më vete (si sasi e kontrollit) edhe bletaria për kontrollin e Pagesave Direkte është një nga fushat e kontrollit ku problemet janë më të shumta. Mosdefinimi i mjaftueshëm i kriterëve gjatë hartimit të programit për subvencionim të bletarisë bënë që problemet të reflektohen tek kontrolli. Problemet që paraqitën tek kontrolli i bletarisë e që vijnë si pasojë e mosdefinimit të duhur nga kriterëve identifikuese nga ana e Hartuesve të Programit, për subvencionimin e kësaj lëmie janë:

- Mosdefinimi i vendosjes së Numrit Identifikues të Fermerit – NIF, në zgjoje, gjatë aplikimit, më ç’rast ai shkruhet me marker të thjeshtë gjatë procesit të kontrollit,

- Lënia e hapsirës së madhe për shpërndarje në kullosë - 7 Vendqëndrime dhe nuk definohet lokacioni, fshati apo vendndodhja e tyre,
- Përkufizimi i numrit të Kornizave për Familje/Bile në Minimum-5 korniza , në këtë rast gjatë kontrollit na del si e padefinuar baza e bletishtës amë.

Këtë vitë kanë aplikuar 2998 bletar dhe kontrollit i janë nënshtruar 2299 aplikantë ose 76.68 % të aplikantëve. Poashtu në supekontrollë ka dalur një kontigjent prej 96 Aplikantësh të kërkuar nga Drejtoria e Pagesave Direkte.

Kontrolli i Pulave Vojse -Po ashtu është kontigjent i vogël dhe nuk krijon probleme gjatë kontrollit nëse është dokumentacioni i precizuar. Ato lëndë që janë plasuar për kontrollë janë kryer 100%. Në këtë fushë kanë aplikuar 99 fermer dhe janë kontrolluar 77 gjithsej: 83,70% e aplikantëve.

Kontrolli i Thëllënzave - Po ashtu është kontigjent i vogël kanë aplikuar 13 fermer dhe 12 janë kontrolluar në përqindje 87,5 % e aplikantëve.

Kontrolli i Bujqësisë Organike - Po ashtu është kontigjent i vogël kanë aplikuar 37 fermer dhe 18 janë kontrolluar ose 48,65 %.

Tabela 55 Numri i Aplikantëve për Pagesa Direkte, Numri i Aplikantëve të Kontrolluar dhe shprehja në % e kontrollit.

Nr	Lloji i Masës për Subvencionim	Numri i Aplikantve sipas Masës	Numri i Kontrollave të realizuara	% e Kontrollit sipas UA/
1	Gruri	10679	4442	41,60 %
2	Lulë dielli	5	5	100 %
3	Misri	8421	3541	42,05 %
4	Elbi / Thekra	399	233	58,4 %
5	Perimet	6662	2964	44,49 %
6	Pemtaria	5276	1522	28,85 %
7	Vreshta	3011	932	31 %
8	Lopë Qumështi	7601	3864	50,84 %
9	Dele	1163	584	50,21 %
10	Dhi	264	135	51,14 %
11	Dosa per Riprodhim	209	197	94,26 %
12	Bletë	2998	2299	76,78 %
13	Pula vojse	92	77	83,70 %
14	Materjal Fidanor	16	14	87,50 %
15	Thëllanza	13	12	92,31%
16	Bujqësia Organike	37	18	48,65 %
17	Verëra	16	13	81,25%
	Totalet	46862	20852	44.50 %

Tabela 56 Lëvizja e numrit të kontrolleve nëpër vite prej vitit; 2013 – 2018.

Viti	Numri i Kontrolleve për Aplikant	Numri i Kontrolleve të realizuara për Masa
2013	16,556	
2014	18,745	
2015	20,171	
2016	19,370	32,098
2017	13,094	23,476
2018	11,162	20,852

Lëndët e padefinuara nga Drejoria e Pagesave Direkte - Kontestet -lëndë të padefinuara gjatë Kontrollit Administrativ janë praktikë e zakonshme në Drejtorinë e Pagesave Direkte, problem paraqet vonesa në zgjidhjen e tyre dhe ardhja më vonesë për kontrollë me ç' rast me kalimin e sezonës së vegjetacionit nuk ka kuptim më edhe kontrolli në teren. Vitin 2018 e kanë përcjellur raste të tilla, sygjerimi ynë është që këto raste të afatizohen dhe të zgjidhen brenda limiteve të parapara me Udhëzim Admimnistrativ dhe Rregullore tjera.

Sasia Mesatare ditore e Qumështit për krerë - Poashtu me Kërkesë të Drejtorisë së Pagesave Direkte është kryer edhe kontrolli i aplikantëve për Litër /Qumësht ludhur me dyshimet dhe rezervat që kanë pasur ata (DPD), lidhur me sasi të aplikuara. Meqë kjo masë e subvencionimit nuk është në Program të Kontrollit (sepse aplikohet përmes pikave

grumbulluese dhe qumëshoreve), gjat kontrollit është përdorur modeli i raportit të granteve me ç'rast është verifikuar: Numri i krerëve total, Numri i krerëve në laktacion, raca dhe lloji i lopëve qumështore dhe është verifikuar një mjelje (e mëngjesit), për të verifikuar sasitë e litrave të aplikuara për subvencion.

Vështirësitë dhe në Kontrollin e Pagesave Direkte

- Numri i madhë i lëndëve për kontrollë, Normat e larta të kontrollit, Mos harmonizimi i normave të kontrollit për masa të aplikuara kur ato janë në një aplikacion për çdo fermer.
- Numri i kufizuar i resurseve njerëzore dhe logjistike, angazhimi i përkohshëm i zyrtarve, Stafi mbështetës i pakualifikuar sa duhet etj.
- Mosdefinimi i mjaftueshëm i kriterëve dhe specifikave në program, (bletaria, kungujt, Mos kompletimi i programit), Vonesat në shpallje dhe shtyrja e afateve të aplikimit.
- Digjitalizimet e gabuara dhe gabimet tjera në aplikim (nga fermerët aplikant apo zyrtarët komunal).
- Problemet me fermer të pandërgjegjshëm që nuk i përgjigjen kontrollit shkaktojnë vonesa të shumta dhe pengimi i inspektorëve në kryerjen e detyrave-Kontrollit në Teren.

Kontrolli i Projekteve të Zhvillimit Rural - Granteve

Kontrolli i Masave të Zhvillimit Rural - Duke patur parasush kohën shumë të shkurtër për ti kryer të gjitha ato kontrolla në kohë dhe me përgjegjësinë maksimale të mundshme për këto kushte. Duke pasur parasysh procedurat e shumta të cilat i zbatojmë ne (sipas standardeve IPA), është një punë shumë e vështirë dhe tepër e ngarkuar. Programi i miratuar me vonesë pa detajet e duhura tekniko teknologjike të nënmasave të ndryshme, është kryer me 14 ekipe kontrolli.

Poashtu kontrollet e **Dyta - Pas aprovimit dhe para pagesës**, janë përfunduar në afat të optimal, para mbylljes së buxhetit dhe arritjes së kuotave të parapara . Në vitin pasues kanë

mbetur për vazhdim të programit të kontrollit: Nënmasa e ujitjes dhe masës, Rikontrollet dhe ankesat e mundshme nga komisioni i ankesaveve përkatëse.

Spektori i kontrollit të projekteve të zhvillimit rural – Granteve në teren si shërbim në kuadër të Drejtorisë së kontrollit, si edhe viteve tjera edhe këtë vit ka kryer funksionet dhe aktivitetet e veta sipas planit vjetor të punës, Programin mbështetës vjetor të MBPZHR për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Rregullores së brendshme të kontrollit si dhe udhëzimeve administrative 05/2018 dhe plotësimin e këtij Udhëzimi me U/A nr. 18/2018, U/A nr.09/2018 dhe plotësimin e këtij Udhëzimi me U/A/16/2018 për masat dhe kriteret për projektet e zhvillimit rural, janë kryer numër i madh kontrollave vjetore për një periudhë mjaft të kufizuar kohore, (kur kemi parasysh vonesat në digasterët tjerë për përgatitjen e programit të masave për vitin 2018, nga autoriteti menaxhues si dhe vonesat nga sektori i miratimit), kontrolli i projekteve dihet që ka qenë në disproporcion të resurseve humane, Teknike dhe teknologjike, por megjithatë kontrolli në teren ka arritur të përmbyllë dhe finalizojë raportet e të gjeturave në teren në kohën e paraparë për të arritur kuotat e caktuara buxhetore.

Poashtu programi i granteve që ka mjaft detaje të padefinuara mbetet për t'u përfunduar gjithëmonë në fund të vitit pasi që vonesat dhe shtyrjet e aplikimeve shkaktojnë gjithëmonë përfundimin e punimeve në fund të vitit që e stërngarkon inspektoratin në mënyrë enorme, në gjashtë mujorin e dytë të vitit, që të mbajë barrën e ekzekutimit në përfundim të vitit fiskal pa mundur të orientohet në kohë dhe cilësi të mjaftueshme të kontrollit.

Stafi prej 3 zyrtarëve në drejtori-qendër dhe 12-14 ekipeve të inspektorëve veçanërisht në kushtet kur në aspektin administrativ, juridik dhe ekonomik-logjistik nuk janë të strukturuar sa dhe si duhet kur kihet parasysh numri i madh i kontrolleve dhe përgjegjësia e vlerësimit të lëndëve që ndërlidhen direkt në operimin me aplikantin, vështirësitë teknike dhe logjistike është një punë kolosale që është arritur të përballohet me një përkushtim të jashtëzakonshëm nga stafi menaxhues dhe inspektorët në teren .

Bazuar në programin mbështetës për bujqësi dhe zhvillim rural të MBPZHR-autoritetit menaxhues dhe udhëzimeve përkatëse administrative të nxjerra për këtë qëllim. Natyrisht që paraprakisht ne kemi zhvilluar me aq sa kemi patur mundësi dhe kohë, aktivitete parapërgatitore dhe trajnuese për t'u përgatitur për kontrollin në teren të parapartë për vitin 2018. Sektori i kontrollit të projekteve për zhvillim rural si gjithënjë ka qenë i varur nga kërkesat për kontrollë në teren të dy drejtorive të projekteve të zhvillimit rural (Nga drejtoria e miratimit të projekteve dhe drejtoria e autorizimit të pagesave).

Realizimit të këtyre aktiviteteve i ka parapri realizimi i procedurave të domosdoshme administrative. Hartimi i planeve të punës, Vlerësimi dhe miratimi i tyre, Rishikimi dhe riplanifikimi i resurseve njerëzore tekniko-profesionale dhe logjistike. Në fillim të vitit është punuar me trajnimet e zakonshme për të parapërgatitur inspektoratin e terrenit për realizimin e programit për vitin 2018.

Vlenë të ceket se puna për hartimin e formës dhe përmbajtjes së raporteve të kontrollit në teren për projektet e zhvillimit rural që është mjaft e rëndësishme, sepse pothuajse çdo vit ballafaqohemi me nënmasa të reja dhe për këtë divizioni i kontrollit i harmonizon dokumentet e kontrollit sipas masave dhe nënmasave në mënyrë që të jenë sa më të qarta, më përmbajtësore dhe të përfshijnë në vete sa më shumë të dhëna mbi të gjeturat e kontrollit në teren.

Vazhdimi i Kontrollit në teren i Projekteve të vitit 2017 të bartura në vitin 2018 - Kanë vazhduar kontrollat për masat e projekteve për zhvillim rural-projektet vitit 2017, të bartura në vitin 2018, të cilave u është vazhduar afati i përmbjlljes së projekteve dhe në proces kemi vazhduar me kontrollin e dytë (Kontrolli pas investimit dhe para pagesës).

Poashtu në këtë grup ka patur edhe rekomandime për rikontrollë me ç'rast nga ky rikontrollë është konfirmuar situata sipas të gjeturave në vend ngjarje për këto masa. Njëkohësisht me kontrollin e dytë të projekteve të mbetura të zhvillimit rural të vitit 2017 e të kryera në vitin

2018 para se të fillohet me punë në kontrollin e PZHR për vitin 2018, Drejtoria e kontrollit, ka kryer edhe superkontrollat dhe ex-post kontrollat e projekteve të vitit 2015. Për numrin e kontrolleve të cekur më lartë dhe kontrollin e PZHR për vitin 2018 paraqesim të dhëna të specifikuar në tabelarin e mëposhtëm. Më poshtë paraqesim në formë tabelare sipas llojit dhe numrit të kontrolleve të kryera.

Tabela 57 Paraqitja grafike e tabelës së masave të kontrolluara para programit - 2018

1	Kontrolli i dytë (pas investimeve dhe para pagesës) i granteve të v. 2017 të kryera në v. 2018	109
2	Rikontrollet e granteve -2018	56
3	Superkontrollat	3
4	Ex-Post Kontrolli , (Kontrolli për përfituesit e vitit - 2015)	242
5	Gjithsejt	410

Kontrolli i projekteve për masat mbështetëse të zhvillimit rural – programi / 2018 - Kontrolli

në teren për masat e zhvillimit rural është një proces i cili varet nga:

- Kriteret e miratuara nga autoriteti menaxhues,
- Detajet teknike të realizimit të projekteve,
- Koha e thirrjes për aplikim,
- Koha e kontrollit administrativ dhe vlerësimit,
- Koha e përgatitjes së listave-urdhërit për kontrollë (Kontrolli i parë dhe kontrolli i dytë),
- Vlerësimi i raporteve të kontrollit, të hartuar nga inspektorët dhe kthimi i lëndës tek Drejtoria e autorizimit të pagesave.

Bazuar në masa dhe sektorë, janë hartuar edhe listat e investimeve të kryera-listat e kontrollit-(Chek-List) si dhe u dizajnuan pesë (5) Raporte të kontrollit sipas masave të cekura më lart.

Pasiqë u hartuan dokumentet e kontrollit, në mënyrë që procesi i kontrollit të jetë më kualitativ, Drejtoria e kontrollit me qëllim të pregaditjes sa më të mirë për t'i zbatuar plotësisht obligimet dhe përgjegjësit e veta në realizimin e programit për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për vitin 2018, ka mbajtur trajnime me stafin , siç është cekur më lartë.

pikat që u shtjelluan në këtë puntori , ishin:

- Baza Ligjore e veprimit
- Procedurat e kontrollit;
- Prezentimi i ndryshimeve në kriteret të caktuara në sektorë dhe masa nga viti paraprak;
- Raportet e kontrollit të masave të zhvillimit rural për vitin 2018 dhe listat e investimeve të kryera sipas masave dhe nënmasave (chek-listat);
- Format e Plotësimit të Raporteve;
- Raportet Mujore të Punës dhe afatet kohore të dorzimit të Raporteve tjera në Drejtorinë e Kontrollit dhe AZHB
- Fillimi i kontrollit të PZHR për vitin 2018 .

Tabela 58 Numri për Projektet e Zhvillimit Rural sipas Masave gjat vitit 2018

Nr	Masat- Sektorët (Nën-masat)	Nr.i Kontrolleve Para Miratimit	Nr.i,Kontronrolleve Para Pagesës	Totali
1	Kontrolli i Dytë i Granteve të v. 2017 i kryer në v. 2018			109
2	Superkontrollat e Projekteve të Kryera 2018			3
3	Rikontrolli i Granteve - 2018			56
4	Ex-post kontrollat e Përfituesve - 2015 në vitin 2018			242
	Gjithsejt			410
	KOTNROLI I GRANTEVE - Programi / 2018			
1	MASAT-101-			
	Masa 101.1-Drufrutore	73	20	93
	Masa 101.5 Rrush	18	11	29
	Sera 101.2a	112	45	157
	Depo për ruajtje të pemëve e perime.101.2b	31	12	43
	Lopë Qumeshtore101.4a	80	43	123
	Dele, Dhi 101.4b	29	11	40
	Pika grumbulluese-101.4c	2		2
	Viça për Majmëri - 101.3a	63	26	89
	Prodh. i mishit të zogut-brojler		1	1
	Derra 101.3b	5	1	6
	Pula në kafaz 101.6	7		7
	Pula në dysheme 101.6	2		2
	Pula në system te lirë 101.6	1		1
	Gjithsej masat 101	423	170	593
	MASAT-101.3-			
	103.2 Perpunim i mishit	3		3
	103.1 Perpunim i qumështit	4		4
	103.3 Perpunim i pemeve dhe perimeve	17	1	18
	103.4 Perpunim i rrushit	4		4
	Gjithsej masat 101.3	28	1	29
	MASAT- 302 -			
	302.1 Bletë	64	49	113
	302.2 Perpunim i prodhimeve bujqësore ne ekonomi familjare	34	23	57
	302.3 Artizanale	21	12	33
	302.4 Turizem rural	18	5	23
	Gjithsej masat 302	137	89	226
	<i>Programi i veçantë</i>	60	1	61
	<i>Masa Speciale</i>	4		4
	GLV	13		13
	MASA E UJITJES			
	Ujitja e tokave Bujqësore	3	3	6
II	GJITHSEJT kontrollë i Granteve të vitit- 2018	668	264	410+932=1,342
	GJITHSEJT Kontrolla të kryera në vitin 2018			
	(I + II), Rikontrolla, Superkontrolla dhe Ex-post kontrolla)		1,342	

Sqarim :

- Gjithesej të pranuar për vitin 2018 nga DMPZHR kanë qenë 668 lëndë për kontrollin e parë
- Gjithesej të kthyera në DMPZHR për vitin 2018 kanë qenë 668 lëndë,
- Gjithesej të pranuar për vitin 2018 nga DAP 264 lëndë për kontrollë të dytë
- Gjithesej të kthyera për vitin 2018 në DAP janë 264 lëndë nga kontrolli i dytë
- PZHR nga viti 2017 janë kryer edhe 109 lëndët e fundit.

56 rikontrolla, pas kontrollit të parë (për ndërrim të lokacionit ku është planifikuar investimi) dhe kontroleve të pjesëshme, si rezultatat i rekomandimeve nga komisionet e kërkesave-Ankesave për lëndët që kanë ardhur nga sektori i miratimit dhe i autorizimit të pagesave, ku ka patur raste që fermerët edhe pse kanë dorzuar kërkesën për pagesë, kur është realizuar kontrolli i dytë, nuk i kanë kryer plotësisht investimet.

Nga masat 101, 302, 103, Ujitja dhe GLV, kanë mbetur që të kontrollohen në vitin pasues (2019), pasi që është vonuar Programi për PZHR dhe si pasojë edhe fermerët janë vonuar me kryerjen e investimeve. Vlenë të ceket se një pjesë e lëndëve për masat të cilat me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2018 kanë afat edhe në vitin vijues, sikurse edhe me U/A nr. 18/2018, U/A nga MBPZHR, janë dyfishuar afatet e PZHR.

Masa-101

- Në sektorin e Masës:101, (ku hyjnë Nënmasat:101 .1; 101. 5; 101.2a; 101.2b; 101.4a; 101.4b;101.4c;101.3a; 101.3b;101.6), në kontrollin e parë (para miratimit), janë inspektuar gjithesej 424 kontrolla të rregullta, ndërsa në kontrollin e dytë (para pagesës), janë inspektuar gjithësej 170 kontrolla.

Masa-103

Tek kjo masë kontrollet janë kryer sipas sektorëve:

- Në sektorin e përpunimi i qumështit dhe i rrushit për kontrollin e parë kanë qenë nga 4 përfitues, ndërsa kontrolli i dytë ende pritet të kryhen investimet .
- Tek përpunimi i mishit në kontrollin e parë kanë qenë 3 përfitues, ndërsa kontrolli i dytë ende nuk është kryer.
- Tek sektori i përpunimit të pemeve e perimeve kontrolli i parë është kryer te 17 subjekte prej të cilave punimet i ka kryer vetëm 1 prej tyre.
- Përpunim i rrushit nga kontrolli i parë kanë qenë 4 përfitues, ndërsa kontrolli i dytë nuk është kryer

Masa-302

Tek kjo masë kontrollet në teren sipas sektorëve janë, si më poshtë:

- Bletaria (masa 302.1) prodhimi/përpunimi dhe marketingu i mjaltit; janë pranuar për kontrollin para miratimit 64 lëndë, kurse Kontrolli i dytë është realizuar te 49 përfitues.
- Grumbullimi dhe përpunimi i prodhimeve të kultivuara 302.2, janë pranuar për kontrollin para miratimit 34 lëndë, kurse Kontrolli i dytë është realizuar te 23 përfitues.
- Për masat tjera : 302.3-Artizanale në kontrollin e parë para miratimit janë kryer 21 kontrolla , ndërsa në kontrollin e dytë janë kryer 12 kontrolla,
- 302.4-Turizëm rural janë kryer në kontrollin e parë 18 kontrolla, ndërsa në kontrollin e dytë 5 kontrolla.

Programi i Veçantë - Në kontrollin e parë kanë qenë 60 kontrolla, ndërsa në kontrollin e dytë vetëm një kontrollë.

Masa Speciale - Kanë qenë përfitues 4 subjekte, tek të cilët është kryer kontrolli i parë (para miratimit), ndërsa kontrolli i dytë ende nuk është kryer.

Masa-303- Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale (LEADER)

Përkrahja për sektorë:

- Funksionalizimi i GLV-ve, janë pranuar 13 lëndë për kontrollin e parë si grante të vitit 2018, kurse kontrolli i dytë dytë nuk ka filluar.

Masa-Ujitja

Te kjo masë kemi pranuar 3 lëndë për Kontrollin e dytë nga viti 2017, kurse 3 tjera kontrolli i parë miratimit, kurse kontrollet e dyta për masën e ujitjes 2018, pritet të realizohen në vitin 2019.

Tabela 59 Struktura dhe Korniza Kohore e zbatimit të Kontrolleve të PZHR-ve në vitin 2018

Muajt e vitit	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Totali
Kontrolli i dytë i Grant. të vitit 2017 në vitin 2018													109
Super kontrolla -2018		3											3
Rikontrollet e Granteve-2018		7	4	8	1					9	23	4	56
Expost-kontrolla 2015		242											242
Kontrolli I & II-të Granteve-2018													
MASA-101													
Pemë drufrutore									49	18		26	93
Perime - Serra									91	18	8	40	157
Qumësht-I/Q,Dele-Dhi								97		10	3	53	163
Mish viçi,derri								60		7	9	20	96
Depo për ruajtje të pemëve e perimeve								30		1	3	9	43
Pikë grumb. të qumësht.								1			1		2
Vezë								6		4			10
Rush								16		2	4	7	29
MASA-103													
Përpunim mishi									3				3
Përpunim i qumështit									2		2		4
103.3-Përpunim i pemë e perime									14	1	3		18
Përpunim i rushit									4				4
MASA-302													
302.1. Bletari									62	4	19	28	113
302.2.Përp. i prodh.bujq.								26	8		2	21	57
302.3. Artizanale								18		3	4	8	33
Turizëm Rural								9			3	11	23
Program i veqant									53		3	5	61
Masa Speciale								4					4
GLV-të							13						13
MASA Ujitja								1			2	3	6
Totali i Kontrolleve në vitin 2017 (K-I+II + rikontrollet, superkontrollet dhe expost kontrollet).									1,342				

Nga tabela shihet se kemi të bëjmë me rrjedhjen e aktiviteteve sipas kornizës kohore nga ku vrehet se aktivitetet e kontrollit të PZHR-ve kanë janë zhvilluar gati gjat gjithë vitit por me dinamikë më të shtuar gjatë gjysmës së dytë të vitit, sidomos gjysma e dytë e muajit Nëntor dhe muaji Dhjetor.

Tabela 60 Krahasimi i numrit të kontrolleve sipas kategorive 2018 dhe 2017

Krahasimi i numrit te kontrolleve te vitit 2018 me vitin 2017					
Nr	Kategoria e Kontrollit	viti 2018	viti 2017	Dallimi	%
1	Kontrolli para Miratimit dhe kontrollat nga viti i kaluar	777	621	156	20
2	Kontrolli para Pageses	264	261	3	1.13
3	Rikontrollet,parakontrola,sup kontrolla	59	54	5	8.47
4	Ex-post	242	167	75	31
5	TOTALI	1342	1103	239	17.80

Nga tabela krahasues, e prezentuar më lartë, shihet se në vitin 2018 kemi rritje të numrit të kontrolleve në të gjitha kategoritë (llojet) e kontrollit dhe në total ky numër në këtë vit është 1327 kontrolla ose më i madhë përr 227 kontrolla apo 16.88 %.

Tabela 61 Totali i kontrolleve të realizuara nga Drejtoria e Kontrollit gjatë vitit 2018, për pagesa direkte dhe grante per vitin 2018

Nr	Kategoria e Kontrollit	Lloji i Kontrollit	Numri i Kontrolleve
1.1	<i>Pagesa</i>	<i>Direkte</i>	20,582
1.2	<i>Pagesa</i>	<i>Direkte-Superkontrollë</i>	104
1.3	<i>Pagesa</i>	<i>Direkte-Rikontrollë</i>	7
2.1	<i>PZHR</i>	<i>Kontrolli i Dytë Para Pagesës/ Prog- 2017</i>	109
2.2	<i>PZHR</i>	<i>Rikontrolli-Drejtoritë , Komisioni i Ankesave</i>	56
2.3	<i>PZHR</i>	<i>Kontrolli i Parë -2018 Para Miratimit</i>	668
2.4	<i>PZHR</i>	<i>Kontrolli i Dytë-2018 Para Pagesës</i>	264
2.5	<i>PZHR</i>	<i>Ex-Post Kontrollë</i>	242
2.6	<i>PZHR</i>	<i>Superkontrollë /2017</i>	3
		Totali	22,035

Vështirësitë gjat kontrollit në teren për Projektet të Zhvillimit Rural - Sa i përket mangësive të përpilimit dhe detajizimit të kriterëve si dhe precizimi i detajeve teknike shpesh reflektohen gjatë kontrollit në teren dhe në procesin e hartimit të raporteve nga kontrolli në teren i cili bie ndesh me projektin e miratuar. Këtu duhet vënë në pah edhe gabimet e shumta teknike gjatë vlerësimit të tyre, mungesat në dokumentacion (që ka raste kur ndodh të mos

dorozohet dokumentacioni komplet që nga zyrtarët rajonal e deri tek zyrtarët e vlerësimit apo autorizimit të pagesave,

Ndryshimet në nënmasat (sektorët) e reja që janë aplikuar këtë vit për të cilat ne nuk kemi pasur përgatitjet e duhura as teorike e as në mjete teknike : Masa 101 (nën masa 101.3- Përpunim i prodhimeve bujqësore), Masa Speciale dhe Masa e Veçantë me ç' rastë inspektorët gjatë kontrollit në teren shpesh është dashur të improvizojmë (Matja e trashësisë së gypave, rezervuarëve të ujit, trashesit e pllakave bazë të betonit si dhe materiale tjera zonat e pa dukshme) dhe kjo paraqet një vështërsi në procesin e kontrollit.

Presionet e ndryshme dhe kërcnimet e inspektorëve gjatë kontrollit në teren edhe pse janë zvogluar mundë të thuhet se ende nuk është arritur një vet dijsim i mjaftueshëm i popullatës për rrespektimin e ligjit dhe të organit shtetror.

Shtimi i masave të reja në Progarmin për Bujësi 2018, njëkohësisht e ka rritur edhe numrin e lëndëve për kontrollë. Inspektorët e angazhuar në kontrollin e PZHR-ve janë në numër mjaft të kufizuar në kontrollin e PZHR, dhe sipas rregullit duhet të ndrrohen inspektorët e kontrollit të parë (para Miratimit) dhe inspektorët e kontrollit të dytë(para Pagesës).

Mos profilizimi i inspektorëve për kontrollin e masave të caktuara të PZHR, mendojë se është edhe një prej dobësive të cilat në të ardhmën duhet të përmissohen.

Në pamundësi të kompenzimit të rrezikshmërisë dhe pagesave për punë jashtë orarit të punës dhe vikendeve është një tjetër dobësi e cila mundë ta ulë motivin për punë efikase.

Mbështetja jo e knaqshme për materiale shpenzuese në zyrë si tonera për kompletimin e raporteve të kontrollit (në pa mjaftueshmëri të ngjyrës së tonerit, ndodh që të del ndonjë foto nga printeri jo shumë e kjart për ndonjë objekt të fotografuar) , vonesat në servisim të veturave dhe cilësia e ulët e servisimit të automjeteve, Fotoaparate, shirit metër etj.).

Vonesat në aplikim, të gjitha këto janë dobësi të cilat vitin në vazhdim presim të përmirësohen dhe të kthehen në avantazhe.

Të arriturat - Duke patur parasysh të gjitha rrethanat, kontrolli është realizuar me efektivitet dhe efikasitet të lartë teknik- profesional dhe moral, prandaj nuk kemi pasur probleme të theksuara në procesin e kontrollit. Përkundër vështirësive në këtë vit kemi ngritje cilësore në procesin e kontrollit dhe hartimit të raporteve, pasi që raportet nga tereni janë shumë më konkrete dhe më të kompletuara me të dhëna për investimet e realizuara nga përfituesit e granteve dhe gjendjen në teren. Bazuar në rekomandimet (të gjeturave) të auditorëve për të dhënat që duhet të përmbaj raportit dhe evitimi i dobësive tjera, me një angazhimi maksimal është rritur përmirësim në raportet e kontrollit. Është përmisuar në një masë edhe qasja e inpektorëve për kontrollë, me ç'ast gjatë vitit 2018, kemi patur më pak raste të ankesave nga fermerët por më shumë ka patur këkesa për pasivizimin e NIF dhe për ndërrime të lokacionit të vend investimit për shkakqe të ndyshme. Nga Drejtoria e Kontrollit tek Drejtoritë Përkatëse lëndët janë proceduar brenda afateve ligjore, dhe për asnjë moment nuk kemi shkaktuar vonesa apo vështërsi në procesin e procedimit të lëndëve tek sektorët tjerë. Në masë të madhe është vërejtur ulje e shkallës për tentim të mashtrimit nga përfituesit e projekteve.

Konkluzionet:

Cilësia dhe efikasiteti i veprimit të kontrollit në teren, mund të themi se janë brenda kriterëve të AZHB-së dhe Dokumenteve tjera të Kornizës Ligjore të veprimit, kjo është vërtetuar nga raportet e hartuara nga inspektorati kanë qenë reale dhe brenda kriterëve të parapara për kontrollin në teren edhe pas ex-post kontrolleve. Rritja e performanceës edhe më tutje ka vend në punën e Inspektoratit dhe të gjith neve.

Nevoja për reforma në numër të inspektorëve dhe profilizimit të tyre për projekte të caktuara do të ndikontet në rritjen e mëtutjeshme të performacës së ispektorëve dhe krahas kësaj do të rritet edhe cilësia, efikasitetin dhe do të zvoglohet e rreziku dhe koha e kryejës së lëndëve të PZHR.

Mbrojtja me Ligj e Inspektoratit para kërcnimeve dhe kërcnuesve, gjatë kontrollit në teren, duhet të inicohet nga sektori Ligjor i AZHB-së dhe MBPZHR , me ndonjë memorandum bashkëpunimi me MPB, të rritet vigjilenca e policisë në mbrojtjen e inspektorëve gjatë ushtrimit të Detyrës Zyrtare dhe në këtë kontekst, të ketë vëmendje më të madhe nga Zyra Ligjore e AZHB, dhe të pëcillet se deri ku po arrijnë procedurat tek organet gjegjëse, për rastet e kërcnimeve të inicuar nga vet inspektorët e AZHB-së.

Kushtet e punës dhe ambienteve të zyrave si dhe paisja me mjete të nevojshme të inventarit, automjeteve është përmirësuar dukshem në vitin 2018, sfidë mbetet paisja me mjete të IT,(Kompjuterë), Fotoaparate dhe Paisje tjera matëse.

Të planifikohet ulja e përqindjes, (zvoglimi i mostrës) së kontrollit të masave të Pagesat Direkte, meqë normat e larta të kontrollit për Pagesa Direkte dhe vonesat në përgatitjen e Programit në tërësi çrregullojnë tërë ritmin e punës në AZHB.

Pagesa e rrezikshmërisë për Drejtorinë e Kontrollit si masë motivuese në përmirsimin e vazhdueshëm të cilësisë së punës, bazuar në rreziqet, presionet dhe kërcnimet nga fermerët gjithashtu edhe nga bartja e sëmundjeve të ndryshme transmiseve të inspektorët gjatë kontrollit i kafshëve, shpezëve dhe rreziqeve tjera të terrenit.

Drejtoria e Teknologjisë Informative (IT)

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë si:

- Regjistri Elektronik i Fermëve (eFR),
- Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS),
- sLPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në teren për sipërfaqe,
- Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin keto module:
 - ✓ Moduli për aplikimit në zyret komunale dhe

- ✓ Modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB
- Regjistri për Menaxhimin e Granteve i cili përfshin keto module:
 - ✓ Modulin për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë të granteve,
 - ✓ Modulin për menaxhimin e granteve,
 - ✓ Modulin për autorizimin e pagesave të granteve,
 - ✓ Moduli i kontrollit në teren për projekte të zhvillimit rural,
- Softueri për indikator si dhe
- Ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe 7 (shtatë) Zyret Regjonale. Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë menaxhimi e të gjithë shfrytëzuesëve (usereve) te domenit të zyrtareve te Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për krijimit të llogarive zyrtare dhe vazhdimin e tyre për qasjen në domenin shtetror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë janë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Drejtoria e Teknologjisë Informative bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Regjistrin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet menaxhimi i granteve, moduli i aplikimit për grante dhe plotësimi i kërkesës për pagesë në zyrët regjonale të AZHB-së, autorizimi i pagesave të granteve dhe moduli i kontrollit ne teren) gjithashtu edhe ruajtja (backup) e të dhënave të serverit ku është i instaluar Regjistri Elektronik i Fermëve (eFR), ruajtja (backup) i të dhënave të Regjistrit për Menaxhimin e Pagesave Direkte si dhe ruajtja (backup) i te dhënave të Sistemit të Thjeshtësuar për Identifikimin e Parcelave të Tokës (sLPIS).

Drejtoria e Teknologjisë Informative gjatë vitit 2018 ka bërë përgaditjen e kampanjes për aplikim për vitin 2018 për Projekte të Zhvillimit Rural sipas masave dhe nenmasave të caktuara në Udhëzimin Administrativ për Projekte të Zhvillimit Rural si dhe përgaditjen e regjistrit për vlersimin, miratimin dhe kontraktimin e projekteve. Pas përgaditjes së regjistrit


per aplikim është bërë trajnimi i zyrtareve regjionla të AZHB-së për regjistrimin e aplikacioneve në sistem si dhe u është dhënë mbeshtetje gjatë gjithë kohës se regjistrimit të aplikacioneve. Për Pagesa Direkte gjatë vitit 2018 është bërë përgaditja për aplikim permes Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin dy module: moduli per aplikimit në zyret komunale dhe moduln për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB ku është bërë përgaditja për aplikim për të gjitha llojet e subevncioneve për vitin 2018 si dhe është bërë përgaditja e Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku është bërë kopjimi komplet i të gjitha parcelave të vitit 2017 ne vitin 2018 (për të lehtësuar aplikimin e fermereve). Pas përgaditjes se kampanjes për aplikim për vitin 2018 është bërë trajnimi i zyrtareve komunal dhe u është dhënë mbeshtetje direkte zyrtareve komunal gjatë regjistrimit të aplikacioneve gjatë gjithë kohë se kampanjes per aplikim. Po ashtu gjatë vitit 2018 është përgaditur kampanja për aplikim per Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therrjet e raportuara të gjedhit për tremujorin e parë TM1, tremujorin e dytë TM2, tremujorin e tret TM3 dhe tremujorin e katërt TM4, po ashtu është përgaditur kampanja për aplikim pe Pagesa Direkte për veren e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, dhe per Pagesa Direkte për Akuakulturë për gjashtëmujorin e parë dhe të dytë 2018, si dhe u është dhënë mbeshtetje zyrtareve komunal për aplikim.

Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen dhe monitorimin e 2 blade enclosure, 7 blade server, 2 MSA storage, 2 External Ethernet Sëitches, 1 unitreds, 1 ultrium tape drive.

Gjatë vitit 2018 ne Regjistrin e Granteve përkatesisht në moduln për miratimin e granteve është perdorur forma dergimit të sms ne mobil tek fermert dhe dergimi i vendimit ne emalin e fermerit per tu njoftuar lidhur me vendimin e marr per aplikacionin e tij gjithashtu e njehta formë e dergimit të sms-it dhe vendimit është perdorur edhe tek Regjistri i Pagesave Direkte.


Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë administrimin e te gjithë regjistrave qe shfrytezon AZHB-ja

Figura 21 Në këtë skemë mund të shihet lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB):



Në këtë skemë mund të shihet Sistemi i Komunikimit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë-AZHB-së, data bazat e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) si dhe komunikimi i rrjetit të internetit në mes të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe Ministrisë së Administratës Publike përkatësisht Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) gjatë vitit 2018.

Figura 22 Sistemi i komunikimit të Agjencisë për zhvillimin e bujqësisë (AZHB).



Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) - do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe / ose burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare. Regjistrimi i fermerve është i rregulluar me "Udhëzim Administrativ nr.07/2011


për regjistrin e fermerve " regjistrimi është vullnetar, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojn për grante dhe subvencione. Gjatë vitit 2016 është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerve.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), Databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike ku gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerve bëhet në zyrët komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyrët Regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Krijimi i përdoruesve dhe administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtorati i Regjistrave varësisht sipas pozitës së zyrtarit që duhet të ju krijohet përdorimi.

Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) ka filluar të funksionoi ne vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermer ndërsa në vitin 2013 kane qenë të regjistruar 26,603 fermer, në vitit 2014 kane qenë të regjistruar 34,775, ne fund të vitit 2015 kane qenë të regjistruar 43,166, ne fund të vitit 2016 kane qenë të regjistruar 50,164, ne fund të vitit 2017 numri i fermerëve te regjistruar në eFR ka arritur në 55,448, ndersa ne fund te vitit 2018 përkatësisht deri me daten 31.12.2018 numri i fermerëve të regjistruar ka arritur në 61017 fermer në 37 komuna të Kosovës. Gjatë vitit 2018 u është dhënë mbështetje direkte gjatë gjithë vitit zyrtarve komunal dhe zyrtarve regjional të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR).

Me poshtë në këtë diagram mund të shihni dallimet e numrit të fermerve nëpër vite të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR):

Figura 23 Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR):




Në Regjistrin Elektronik të Fermerve (eFR) përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësor si dhe nënshkrimi i fermerit. Për fermerin i kemi të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që mirren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj. Për tokën në shfrytëzim i kemi të dhënat për tokën e punueshme si ara, kopshte, lëndinë e përhershme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqën e tokës në pronë në hektar dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qëra, patate mbi 10 (dhjetë) hektar, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) hektar, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) hektar, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) hektar.

Për kafshë i kemi të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për

mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogj, bletë etj. Për mekanizëm i kemi të dhënat për traktorë, motokultivatorë dhe autokombanja, dhe është pjesa e nënshkrimit ku në këtë pjesë përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit.

Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, "NIF" do të thotë Numri Identifikues i Fermës. Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit ku në aneksin e eFR-së nënshkruhet zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri. Regjistri Elektronik i Fermave (eFR) është i lidhur me Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) ku nuk mund të kalohet në sLPIS pa qenë i regjistruar në eFR. Në skemën e mëposhtme mund të shihet procesi i regjistrimit të fermerit në eFR:

Figura 24 Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR



Me poshtë mund të shihni Regjistrin Elektronik të Fermëve (eFR) i cili është ueb aplikacion dhe funksionon në tri gjuhë: Shqip, Anglisht dhe Serbisht:

Figura 25 Regjistrin Elektronik të Fermëve (eFR) ueb aplikacioni.

Në eFR është i nderlidhur sLPIS-i (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) dhe Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku pasë regjistrimin ne eFR te dermerit kalohet ne menyre automatike ne sLPIS për digjitalizim te parcelave te tokes, po ashtu në menyre autoatike kalohet ne Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte ku bëhet aplikimi për të gjitha llojet e pagesave direkte.

Ne figuren e me poshtme mund të shihet çertifikate e regjistrimit të fermereve ne Regjistin Elektronik të Fermereve (eFR) se bashku me aneksin e të dhënave të fermerit.

Figura 26 Çertifikate e regjistrimit të fermereve



The image shows a certificate of farmer registration from the Agriculture Development Agency of Kosovo. It features the national coat of arms at the top center, followed by the text 'Republika e Kosovës', 'Republika Kosova-Republic of Kosovo', and 'Qeveria -Vlada - Government'. Below this, it lists the 'Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural' and the 'Agencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencia za Razvoj Poloprivrede/The Agriculture Development Agency'. The main title is 'ÇERTIFIKATË E REGJISTRIMIT TË FARMERIT'. The certificate states that the holder is a registered farmer with a personal number 1231231239 and a farm identification number 1050486. It is signed by the Executive Director, Ekrem GJOKAJ, and dated 22.03.2016. A note at the bottom explains that Annex 1 is a necessary part of the certificate and that farmers are obligated to report any changes to the authorities to avoid the annulment of the certificate.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development

Agencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencia za Razvoj Poloprivrede/The Agriculture Development Agency

ÇERTIFIKATË E REGJISTRIMIT TË FARMERIT

vërteton se

Test Test

me numër personal 1231231239

është fermer i regjistruar
me numër identifikues të fermës

1050486

Kryeshefi Ekzekutiv
Ekrem GJOKAJ
Ekrem Gjokaj

Data e regjistrimit
22.03.2016

Aneksi 1 është pjesë e nevojshme e kësaj çertifikate.
Fermeri është i obliguar të lajmrojë autoritetet për çdo ndryshim lidhur me informatat e dhëna në Aneksin 1.
Mospërbushja e këtij obligimi mund të rezultojë në anulimin e kësaj çertifikate
(Udhëzimi administrativ 7/2011 An 5, par 2)

ANEKS 1-SHËNIMET E FERMERIT TË REGJISTRUAR - AZHURNIMI I FUNDIT MË 31.03.2016

ANEKS 1- PODACI NA REGISTAR FARMERA - DATUM ZADNJE PROMJENE 31.03.2016

1. Zgjidh llojin e entitetit/ Izaberi tip lica? Person Fizik/Fizicko Lice Person Juridik/Pravno Lice

1a. Të dhënat për Personin Fizik (Fermerin)/Podaci o Fizickom Licu (Farmeru)

Emri i Ime	Test	Mbiemri i Prezime	Test
Emri i babait/ Ime oca	Test	Data e lindjes/ Datum rodjenja	12.12.1980
Numri Personal/ Licni broj	1231231239		

1b. Të dhënat për Personin Juridik/ Podaci o Pravnom Licu

Emri i Personit Juridik/ Ime Pravno Lice			
Nr. Reg. Biznesit/ Reg. broj Biznesa	0	Nr. Fiskal/ Fiskalni broj	0

1c. Të dhënat për Administratorin (Menaxherin)/Podaci o Administratoru (Menadzera)

Emri i Ime		Mbiemri i Prezime	
Emri i babait/ Ime oca		Data e lindjes/ Datum rodjenja	
Numri Personal/ Licni broj			

1d. Adresa dhe informatat kontaktuese/Adresa i kontakt informacijec

Komuna/ Opstina	Prishtinë	Fshat/ Selo	Prishtinë	Koord. 1	4702954
Rruga/ Ulica		Nr i shtëpisë/ Kucni broj		Koord. 2	469851
Kodi Postar/ Postanski kod		Emri i zyrës postare			
Telefoni	044/000/000	e-mail @	test@hotmail.com		
Numri i llogarisë bankare/ Bankarski ziroacun	1500000005000000	Emri i bankës/ Naziv banke	Raiffeisen Bank Kosovo		

INFORMATA LIDHUR ME SHFRYTËZIMIN E TOKËS NGA FERMA
PODACI U VEZI KORISCENJA ZEMLJISTA U FARMU

Numri Broj	Land Unit Type	Pronë (Jo atë të dhënë me qera) Vlastnitvo (Ne ono izdato na zakum)	E marrë me qera (me ose pa pagese) Uzet na zakup (sa ili bez naknade)
202	Kopshte		
203	Lëndinë e përhershme		
204	Pemishtet		
204	Vreshtat		
205	Pyjet		
205	Të tjerat		
201	Tokë e punueshme-ara	5	0

Kriteret/ Kriteri	P/D	J/N
Patate > 10ha	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
Drithëra > 50ha	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
Bimë Industriale	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
Hortikulture e hapur > 3ha	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
Hortikulture e mbuluar > 0.3ha	<input type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>

**INFORMATA LIDHUR ME KAFSHËT QË MBAHEN NË FERMË
INFORMACIJE O ZIVOTINJA KOJE SE DRZE U FARMU**

4. Dele dhe Dhi

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3030199	Dele tjera (desh, qingja, runza)	
3030201	Dhi për mbarështim	
3030299	Dhi tjera (cjep, keca, ftuja)	
3030101	Dele për mbarështim	50

7. Derra

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3040100	Derra nën 20 kg	
3040200	Dosat për mbarështim mbi 50 kg	
3049900	Derra tjere	

8. Kuaj, Gomarë

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3010000	Kuaj, Gomarë etj.	

11. Shpezë

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3050200	Pula	
3050100	Zogj	
3050300	Shpeze tjera	

12. Bletë

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3070000	Bletë	

13. Lepuj

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3060000	Femra për mbarështim	

14. Të tjerat

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3080000	Të tjerat	

21. Gjedhë

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
3020500	Mëshqerra (mbi 2 vjet)	
3020400	Dema (mbi 2 vjet)	
3029900	Te tjera (femra mbi 2 vjet)	
3020200	1 deri 2 vite meshkuj	
3020300	1 deri 2 vite femra	
3020100	Nën 1 vjet (te gjitha)	
3020600	Lope qumështore	10

**INFORMATA LIDHUR ME MEKANIZIMIN NË FERMË
INFORMACIJE O MEHANIZACIJI NA FARMI**

1. Mekanizimi / Mehanizacija

Kodi/Kod	Përshkrimi/Opis	Numri/Broj
40101a	Traktor	
40101b	Motokultivator	
40101c	Autokombajnë	

- NË RAST TË NDRYSHIMEVE

- Në rast të ndryshimeve të çfarëdo informacioni që ka të bëjë me këtë Regjistrim të Fermerëve, ju lutem kryqëzojeni me stilolaps informacionin e vjetër dhe shkruani sipër një të ri, të saktë. Pastaj, ju lutem kthehuni mbrapa te Autoriteti Lëshues në mënyrë që të kryhet azhurnimi.
- Bazuar në përgjegjësitë tija, Unë konfirmoj se ndryshimet e mësipërme janë të sakta dhe të vërteta dhe se informatat e përdryshuara janë ende të vlefshme.

Nënshkrimi i fermerit/Potpis Farmera

- U SLUCAJU PROMENA

- U slucaju promena bilo koje informacije koja se odnosi na ovu Registraciju Farmera, molimo vas da precrtate olovkom na zastarele informacije i napišite gore novu ispravnu informaciju. Zatim, molimo vas da se vratite nazad kod Autoritet Izdavanja kako biste obradili ispravku.
- Na osnovu zakonskih odgovornosti, ja gore navedeni potvrđujem da su promene tačne i istinite i da su nepromenjene informacije i dalje vazeće.

Datë/ Datum:

Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) - përmes këtij sistemi gjatë vitit 2018 është bërë aplikimi për 49 kultura bujqësore ato janë: kultura lavertare 7 (grurë, farë gruri, misër, luledielli, elbi dhe thekra) për perime në fushë të hapur për 25 kultura (lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan i zi, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungulleshë, kunguj misri, asparagu, brokoli, fasule monokulturë, bizele, kungulli, speci, marulla, majdanozi dhe rrepka) dhe për 16 kultura pemëtare permanente (molla, dardha, ftoi, mushmolla, kumbulla, kajsia, arra, lajthia, aronia, pjeshka, qershia, vishnje, dredhëza, manaferra, mjederr dhe boronica) si dhe vreshtat egzistuese. Pas hapjes së kampanjës për vitin 2018 janë trajnuar zyrtarët komunal për digitalizimin e parcelave dhe u është dhënë mbështetje direkte gjatë digitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermerve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) është i nderlidhur me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit ku jemi duke i shfrytëzuar të dhënat për zonat kadastrale, kadastrin e parcelave, lumenjtë dhe hekurudhat. Me poshtë mund të shihni se si duket lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit. Në këtë skemë mund të shihet funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE

Figura 27 Lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit.





Figura 28 Funkionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE



Aplikimi i fermerve për mbështetje ka qenë në rritje të vazhdueshme nëpër vite. Më poshtë do ti paraqesim aplikimet e fermerve nëpër vite. Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2011) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 8,825 fermer dhe janë digjitalizuar 37,891 parcela me grurë me 43,008.02 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 2,341 fermer dhe janë digjitalizuar 5,989 parcela me misër me 5,983.72 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 32 fermer dhe janë digjitalizuar 87 parcela me luledielli me 769.79 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2011/12 është 43,967 ndërsa i hektarve 49,761.53 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 (kampanja për aplikim për grurë është hapur në dhjetor të vitit 2012) për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,728 fermer dhe janë digjitalizuar 49,106 parcela me grurë me 53,933.52 hektar, ndërsa për misër kanë aplikuar 3,726 fermer dhe janë digjitalizuar 11,202 parcela me 10,233.85 hektar dhe për luledielli kanë aplikuar 31 fermer dhe janë digjitalizuar 73 parcela me 487.12 hektar.

Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2012/13 është 60,381 ndërsa i hektarve 64,654.49 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,781 fermer dhe janë digjitalizuar 50,168 parcela me 52,003.32 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 41 parcela me 439.11 hektar, për misër kanë aplikuar 6,084 fermer dhe janë digjitalizuar 16,726 parcela me 15,171.26 hektar, për luledielli kanë aplikuar 14 fermer dhe janë digjitalizuar 37 parcela me 653.69 hektar dhe me perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,950 fermer dhe janë digjitalizuar 5,770 parcela me 3,889.05 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2014 është 72,742, ndërsa i hektareve 72,156.43 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,993 fermer dhe janë digjitalizuar 46,905 parcela me 47,289.34 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 17 fermer dhe janë digjitalizuar 49 parcela me 417.89 hektar, për misër kanë aplikuar 8,336 fermer dhe janë digjitalizuar 24,123 parcela me 21,091.00 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 23 parcela me 304.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 2,738 fermer dhe janë digjitalizuar 8,959 parcela me 5,870.85 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 4,291 fermer dhe janë digjitalizuar 7,700 parcela me 4,567.97 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2015 është 87,759 ndërsa i hektareve 79,541.62 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 11,859 fermer dhe janë digjitalizuar 55,008 parcela me 52,722.66 hektar, ndërsa për


farë gruri kanë aplikuar 26 fermer dhe janë digjitalizuar 72 parcela me 775.78 hektar, për misër kanë aplikuar 7,978 fermer dhe janë digjitalizuar 24,091 parcela me 20,044.2 hektar, luledielli kanë aplikuar 2 fermer dhe janë digjitalizuar 2 parcela me 9.88 hektar, për theker kanë aplikuar 76 fermer dhe janë digjitalizuar 150 parcela me 245.08 hektar, për elb kanë aplikuar 156 fermer dhe janë digjitalizuar 329 parcela me 285.14 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,439 fermer dhe janë digjitalizuar 10,359 parcela me 7294.75 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 43 parcela me 111.9 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 5,795 fermer dhe janë digjitalizuar 9,284 parcela me 5,368.18 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2016 është 99,338 ndërsa i hektareve 86,857.57 ha.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2017 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 9,709 fermer dhe janë digjitalizuar 44,669 parcela me 42,381.02 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë digjitalizuar 46 parcela me 513.14 hektar, për misër kanë aplikuar 8,598 fermer dhe janë digjitalizuar 28,120 parcela me 23,914.52 hektar, luledielli kanë aplikuar 7 fermer dhe janë digjitalizuar 9 parcela me 56.33 hektar, për theker kanë aplikuar 78 fermer dhe janë digjitalizuar 153 parcela me 201.99 hektar, për elb kanë aplikuar 227 fermer dhe janë digjitalizuar 488 parcela me 423.57 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 5,712 fermer dhe janë digjitalizuar 11,310 parcela me 7,928.36 hektar, për bujqësi organike kanë aplikuar 13 fermer dhe janë digjitalizuar 70 parcela me 149.07 hektar dhe kultura pemtare permanente kanë aplikuar 7,181 fermer dhe janë digjitalizuar 11,604 parcela me 6,805.51 hektar.

Gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 për mbështetje direkte për grurë kanë aplikuar 10,674 fermer dhe janë digjitalizuar 50,844 parcela me 47,303.09 hektar, ndërsa për farë gruri kanë aplikuar 11 fermer dhe janë digjitalizuar 50 parcela me 464.34 hektar, për misër kanë aplikuar 8,416 fermer dhe janë digjitalizuar 28,036 parcela me 23,370.36 hektar, luledielli kanë aplikuar 5 fermer dhe janë digjitalizuar 8 parcela me 7.91 hektar, për theker kanë aplikuar 83 fermer dhe janë digjitalizuar 158 parcela me 240.81 hektar, për elb kanë aplikuar 315 fermer


dhe janë digjitalizuar 694 parcela me 570.80 hektar, perime në fushë të hapur kanë aplikuar 6,878 fermer dhe janë digjitalizuar 13,260 parcela me 9,080.23 hektar, per bujqësi organike kanë aplikuar 37 fermer dhe janë digjitalizuar 156 parcela me 420.24 hektar dhe kultura pentare permanente kanë aplikuar 8,050 fermer dhe janë digjitalizuar 12,735 parcela me 7,833.94 hektar. Totali i parcelave të digjitalizuara gjatë fushatës së aplikimit për subvencione 2018 është 105,941 ndërsa i hektareve 89,291.72 ha. Në këtë grafikon mund të shihet numri i fermerve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it, numrin e parcelave dhe sipërfaqën e digjitalizuar gjatë kampanjave për palikim për subvencione 2011/12, 2012/13, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018:

Figura 29 Numri i fermerve që kanë aplikuar përmes sLPIS-it.



Më poshtë mund të shihni Sistemin e Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS):


Figura 30 Sistemin e Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës.



Për kontrollë në teren nga inspektorët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë përdorën sLPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline) ku ngarkohën të dhënat nga Sistemi i Thjeshtesuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) në sLPIS-Mobile vetem me qasje të lloptopit në rrjet qeveritar dhe bartja e të dhënave nga sLPIS-Mobile në Sistemin e Thjeshtesuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i sLPIS-Mobile në lloptop është bërë nga Drejtoria e Teknologjisë Informative po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në teren.

Më poshtë mund të shihni sLPIS-Mobile i cili funksionon (offline) pa qasje në rrjet të internetit i cili përdoret nga inspektorët për kontrollë në teren:

Figura 31 sLPIS-Mobile i cili funksionon (offline)




Regjistri i Granteve: Ky regjister përmban:

- Modulën për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë
- Modulën e miratimit të granteve,
- Modulën e autorizimit të pagesave si dhe
- Modulën e kontrollit në teren

Regjistri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrët regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB ku bëhet aplikimi sipas masave dhe nënmasave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Gjatë vitit 2018 ruajtja e të dhënave gjatë aplikimit është bërë në server të AZHB-së dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët përgjegjës të miratimit të projekteve kanë mundur të shohin të dhënat e fermerëve që kanë aplikuar sipas masave dhe nënmasave dhe shumën e projektit që ka aplikuar. Gjatë plotësimit të kërkesës për pagesë gjatë vitit 2018 janë regjistruar të gjitha fakturat që janë sjelluar nga fermerët që kanë bërë kërkesë për pagesë, gjatë gjithë kohës zyrtarët e Autorizimit të Pagesave mund të shohin

se sa fermer kanë bërë kërkesë për pagesë. Më poshtë mund të shihni Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë i cili funksionon në shtatë zyret regionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:


Figura 32 Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë



Miratimi i granteve: Gjatë vitit 2018 Regjistri për Miratimin e Granteve është përgaditur për miratimin e granteve të vitit 2018 sipas Udhëzimit Administrativ 2018. Pas aplikimit në softuerin për aplikim për grante, zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me udhëzimin administrativ të vitit përkatës, përmes këtij softueri gjenerohen letrat informuese, bëhet përgaditja e kontrates që nënshkruhet nga fermeri dhe AZHB-ja, po ashtu përmes këtij softveri bëhet dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur me vendimin e marr për aplikacionin e tij.

Më poshtë mund të shihni softuerin për miratimin e granteve që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB:


Figura 33 Softuerin për miratimin e granteve



Autorizimi i Pagesave: Gjatë vitit 2018 ky modul është përgaditur për Autorizimit të Pagesave të vitit 2018 ku kërkesat për pagesë janë plotësuar në zyret regjionale të AZHB-së, kalkulimi dhe autorizimi i pagesave është bërë nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave ku bëhet kalkulimi i fakturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në teren dhe përgaditja e listës për pagesë.

Më poshtë mund të shihni softuerin për autorizimin e pagesave që shfrytëzohet nga zyrtarët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB.

Figura 34 Softuerin për autorizimin e pagesave



Moduli i kontrollit në teren: Ky modul përdoret nga Drejtoria e Kontrollit ne Teren, ku përmes këtij moduli nga Drejtori i Drektorit së kontrollit caktohen lendet per kontroll ne teren dhe percaktohen per secilen lende nga dy (2) inspektor.


Pas definimit te lendeve, permes modulit te inspektoreve, secili inspektor sheh lendet qe ju kan caktuar per inspektim. Pas kontrollit ne teren inspektoret qasen ne kete modul ku ne sistem plotesojn te gjeturat ne teren dhe ne menyre automatike raporti kalon tek shefi apo personi pergjegjes te Modulit te Kontrollit, ku dhe behet vlersimi/pranimi i kontrollit.

Pergjegjesit e Drejtoris se Kontrollit, e bejn pranimin e lendes dhe vlersimin e raportit te kontrollit ne teren, dhe pas ketij vlersimi, lenda bartet ne menyre automatike tek

departamentet perkatese. Nese eshte kontrolli i I-re, ateher lenda bartet tek Miratimi i Projekteve ndersa nese lenda eshte e kontrollit te II-te, lenda bartet tek Autorizimi i Pagesave.

Më poshtë mund të shihni modulën e kontrollit në teren që shfrytëzohet nga inspektorët e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë – AZHB.

Figura 35 Moduli i kontrollit në teren



Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Regjistri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Ky ueb aplikacion përfshin dy module: moduli për aplikimit në zyret komunale dhe modulën për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Përmes këtij ueb aplikacioni është bërë aplikimi për të gjitha pagesat direkte për sipërfaqe (grur, miser etj, kultura përmtare permanente) si dhe të gjitha aplikimet për krerë (lopë qumeshtore, dele, dhi, blet etj.). Ky aplikacion është i ndërlidhur edhe me sLPIS (Sistemi i Thjeshtezuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) ku pas digjitalizimit të parcelave bëhet aplikimi përmes këtij ueb aplikacioni.

Më ueb aplikacionin e pagesave direkte bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lëndëve për kontroll në teren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagese si dhe dërgimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur me vendimin e marrë për aplikacionin e tij, përmes këtij ueb aplikacioni bëhet komplet menaxhimi i pagesave direkte. Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative në këtë ueb aplikacion ka bërë krijimin e shfrytëzuesëve (userëve), rikthimin në aplikim të aplikacioneve që kanë bërë gabime zyrtarët komunal gjatë aplikimit si

dhe mirëmbajtjen e të dhenave. Më poshtë mund të shihet Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Figura 36 Regjistrin për Menaxhimin e Pagesave Direkte


The screenshot displays the 'Subsidies' management page. On the left is a dark sidebar with navigation links: SQ | EN | SR, Logout, Direct Payment v5.6.7.3, Administration, Definitions, Unit measures, Subsidy types, Subsidy subtypes, Subsidy groups, Subsidy criteria groups, Subsidy sanction groups, Subsidies, Documents, Applications, Reports, Campaigns, and Change my password. The main content area has a '+ Add' button and a search bar with filters for Name, SubsidySubtypeId, Category, and SubsidyGroupId, followed by a 'SEARCH' button. Below the search bar is a table with the following data:

Name	SubsidySubtypeName	UnitMeasureName	PriceType	Category
Akuakulturë	Tjera	Copë	Fiks	Vjetor
Aronia	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Arra	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Asparagu	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bizele	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Bletë	Bletë	Copë	Fiks	Vjetor
Boronica	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Brokoli	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Buallica	Gjedhë	Krerë	Fiks	Vjetor
Bujqësia organike	Kulturat pemëtare	Hektar	Fiks	Permanent
Dele për mbarështrim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Dhi për mbarështrim	Dele dhe Dhi	Krerë	Fiks	Vjetor
Domate	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor
Dosat për riprodhim	Derra	Krerë	Fiks	Vjetor
Dredhëza	Tokë e punueshme	Hektar	Fiks	Vjetor

At the bottom of the table, there is a pagination bar showing page 1 of 62, with buttons for navigation and a '1 - 15 / 62' indicator.

Më poshtë mund të shihni aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte për të gjitha subvencionet.

Figura 37 Aplikacionin për aplikim për Pagesa Direkte



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development
 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agjencia za Razvoj Poljoprivrede/The Agriculture Development Agency

FORMULAR PËR APLIKIM/ OBRAZAC ZA APLIKACIJU
Pagesat Direkte

NIF: 1050486 Nr:30/01266 Viti

1. Zgjidh llojin e entitetit/ Izaberi tip lica? Person Fizik/Fizicko Lice Person Juridik/Pravno Lice

1a. Të dhënat për Personin Fizik (Fermierin)/Podaci o Fizickom Licu (Farmeru)

Emri i Ime	Test	Mbiemri/ Prezime	Test
Emri i babait/ Ime oca	Test	Data e lindjes/ Datum rodjenja	12/12/1980 12:00:00 AM
Numri Personal/ Licni broj	1231231239	Telefoni/ Telefon	044/000/000
Komunal/ Opština	Prishtinë/ Pristina	Vendbanimi/ Naselje	Prishtinë/ Pristina

1b. Të dhënat për Personin Juridik/ Podaci o Pravnom Licu

Emri i Personit Juridik/ Ime Pravno Lice			
Nr. Reg. Biznesit/ Reg. broj Biznesa	0	Nr. Fiskal/ Fiskalni broj	0

II. Aplikacioni është komplet/Aplikacija je kompletna PO JO

Në rast të mungesës së dokumenteve aplikanti do të dorëzojë dokumentet përkatëse brenda një periudhe prej 5 ditë pune!
 U slučaju nedostataka dokumentacije aplikant će predati dokumente u okviru perioda od 5 radnih dana!

Grurë	Hektar	0.41
Domate	Hektar	0.80
Pemë molle	Hektar	0.48
Lope qumështore	Krerë	5.00
Dele për mbarëshëm	Krerë	150.00
Dhi për mbarëshëm	Krerë	10.00

- Deklaratë: 1. Konfirmoj që të gjitha të dhënat e ofruara në këtë aplikacion janë korrekte dhe unë do të ballafaqohem me pasojat ligjore në rast se të dhënat nuk janë të sakta apo mungojnë. 2. I vë në dispozicion të gjitha të dhënat dhe informatat për kontrollin në terren. 3. Unë lejoj përdorimin e këtyre të dhënave në të gjithë regjistrat e MBPZHR dhe ESK.	- Izjava: 1. Potvrdijem da svi podaci u ovoj aplikaciji su korektni i tačni i da ću snositi zakonske posledice ako su podaci netačni i neistiniti ili nedostaju. 2. Ja učiniću dostupnim sve podatke i informacije za terensku kontrolu. 3. Dajem saglasnost da se ovi podaci upotrebe u registre MPSRR i SOK.
---	---

Viti dita/dan muaji/mesec viti/god

(Nënshkrimi i aplikantit / (personit të autorizuar)
(Potpis aplikanta / (ovlaćenog lica)

(Nënshkrimi i zyrtarit komunal)
(Potpis opštinskog slubenika)

NIF: 1050486 Faqe/Strana 1 nga/od 1 Datë/ Datum:

Softueri për Indikator: Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Teknologjisë Informative ka bërë mirëmbajtjen e softuerit të Indikatoreve ku në menyre automatike është bërë plotësimi i Indikatoreve, ky softue është i ndërlidhur me Grant Menaxhmenti dhe janë të harmonizuara të gjitha tabelave ku bëhet shkembimi automatik i të dhënave. Më poshtë mund të shihni softuerin për indikator i cili funksionon në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Figura 38 Softuerin për indikator

The screenshot shows a web application interface for project indicators. The interface is in Albanian and includes a navigation menu at the top with options like 'Treguesit', 'Raportet e avancuar', 'Graphical reports', 'Adhresimet', 'Ditë', and 'Kryesit'. Below the menu, there is a section titled 'Freguesit' and a table labeled 'Tabela: Project Indicators'. The table has a blue header and contains multiple rows of data. The columns include 'Vite', 'Masa', 'Niveli i masës', 'Entiteti', 'Orizentimi / Niveli i masës për projektin', 'Përfaqësi (%)', 'Kodi (ID)', 'Vlera totale e shërbimit publike', 'Shtetësi / shtetësi të pranishëm i', 'Produkti', 'Fillesat', 'Të më', 'Pëna', 'Totali i vlerës aktuale të pranishme raportuar në shtetësi', 'Shtetësi / shtetësi të pranishëm i raportuar në shtetësi të pranishëm i', 'Të pranishme', 'Të zgjedhura', and 'Të bashkuara'. A yellow highlight is visible on one of the rows in the table.

Ueb faqja: Mirëmbajtja e ueb faqës së Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë Informative. Gjatë vitit 2018 janë publikuar të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikues, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Publikimi i këtyre informatave është bërë në gjuhën Shqipe dhe Serbe.

Me poshtë mundë të shihni se si duket ueb faqja e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqesisë – AZHB.

Figura 39 ueb faqja e Agjencionit për Zhvillimin e Bujqesisë – AZHB

